



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 1113 Prot.

Tiranë, më 31.12.2016

V E N D I M

Nr. 181¹ Datë 31.12.2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT“MBI VERIFIKIMIN E ZBATIMITTË DETYRAVE DHE MASAVE TË REKOMANDUARA NË TREMUJORIN E IV- 2015 DHE PERIUdhËN E 9/MUJORIT VITIT 2016.

USHTRUAR NË 38 SUBJEKTET E AUDITUARA, 10 SUBJEKTE NË TREMUJORIN E IV- 2015 DHE 28 SUBJEKTE TË AUDITUARA PËR PERIUdhËN E 9/MUJORIT TE VITIT 2016.

BASHKITË: PËRMET HAS, BULQIZË, BELSH, LIBOHOVË, FUSHË-ARRËZ, MIRDITË, KURBIN, MALLAKASTËR, KONISPOL, SHIJAK, MALIQ, POGRADEC, GJIROKASTËR, LUSHNJË, KORÇË, FIER (ISH-KOMUNA MBROSTAR), CËRRIK, BERAT (BASHKIA BERAT, KONCESIONI I PARKIMIT DHE ISH-KOMUNA OTLLAK), BASHKIA VLORË, SKRAPAR, POLIÇAN, ELBASAN, MALËSI E MADHE, LEZHË, (BASHKIA LEZHË DHE ISH-KOMUNA BALLDRE), SHKODËR (ISH-KOMUNA VELIPOJË), VAU I DEJËS (ISH-KOMUNABUSHAT), PËRRENJAS, (ISH-KOMUNA GOSTRIMË), RROGOZHINË, TIRANË (ISH-KOMUNA PETRELË, AUDITIMET TEMATIKË PËR: ISH-KOMUNAT PEZË, VAQAR, NDËRTIMIN E UNAZËS VOGËL BASHKIA TIRANË DHE DREJTORINË PËR SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI E SHPËTIMIN-BASHKIA TIRANË; INSTITUCIONI I PREFEKTIT QARKU TIRANË, KËSHILLI I QARKUT TIRANË, DURRËS DHE VLORË.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Udhëzimin e Kryetari të KLSH, nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

¹ Vendim i amenduar me vendimin e datës 27.01.2017.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar Përmbledhës të Auditimit "Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e 10 subjekteve për tremujorin e IV -të vitit 2015 dhe 28 subjekteve për periudhën e 9/mujorit 2016".

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara si vijon:

I. MASA ORGANIZATIVE

a.Për subjektet e audituara për periudhën e 9 mujorit 2016.

Nga auditimi i realizuar në 28 subjektet e verifikuara për zbatim rekomandimesh rezultoi një nivel i pranueshëm zbatueshmërie në masën 72 %, (401:478) nga 497 masa organizative të rekomanduara janë pranuar 478 masa dhe nuk janë pranuar 10 masa. Nga masat e pranuar janë zbatuar në total 401 masa organizative, prej tyre janë zbatuar plotësisht 158 masa, 233 masa janë në proces zbatimi dhe nuk janë zbatuar 77 masa. Subjektet të cilat nuk kanë zbatuar masat organizative të rekomanduara nga KLSH janë: Bashkia Përrenjas 20 masa, Berat 15 masa, Libohovë 8 masa, Belsh, Maliq dhe Rrogozhinë nga 5 masa secila, etj. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

b.Për subjektet e audituara në tremujorin e IV-të të vitit 2015

Nga 204 masa organizative të rekomanduara, në 10 subjekte të audituara gjatë periudhës tremujorit IV-të 2015, janë pranuar 202 masa prej tyre janë zbatuar 176 masa disiplinore ose në masën 86 %, duke mos u zbatuar 26 masa, respektivisht; 15 masa i përkasin ish-Komunës Petrelë, (aktualisht Njësi Administrative në përbërje të Bashkisë Tiranë) dhe 9 masa nuk janë zbatuar nga Bashkia Gjirokastrë.

1. BASHKIA FUSHË ARRËZ

Nga KLSH janë rekomanduar 19 masa organizative të cilat janë pranuar, prej tyre janë në proces zbatimi 9 masa dhe nuk janë zbatuar 10 masa organizative, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

2. BASHKIA HAS

Nga KLSH janë rekomanduar 22 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 3 masa, janë në proces zbatimi 14 masa dhe nuk janë **zbatuar 5 masa**, për të cilët **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

3. BASHKIA BULQIZË.

Nga KLSH janë rekomanduar 16 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre është zbatuar plotësisht 1 masë, janë në proces zbatimi 11 masa dhe nuk janë zbatuara 4 masa, për të cilët **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

4. BASHKIA MIRDITË

Nga KLSH janë rekomanduar 17 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre është zbatuar plotësisht 1 masë, janë në proces zbatimi 15 masa dhe 1 masë nuk është zbatuar, për të cilët **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

5. BASHKIA KURBIN

Nga KLSH janë rekomanduar 22 masa organizative, të cilat janë pranuar , prej tyre janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces zbatimi 16 masa dhe nuk janë zbatuar 4 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

6. BASHKIA SHKODËR

Nga KLSH me shkresën nr.550/11, datë 20.10.2015, janë rekomanduar 29 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar 24 masa, 2 masa dokumentacioni ndodhet në prokurori ndërsa 3 masa janë në proces zbatimi, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

7. BASHKIA LEZHË

Nga KLSH me shkresën nr. 1105/10, datë 30.04.2016, janë rekomanduar 20 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 12 masa, janë në proces zbatimi 4 masa, dhe janë të pa zbatuara 4 prej tyre, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

8. BASHKIA LEZHË (për detyrimet e Ish-Komunës Balldren i Ri)

Nga KLSH me shkresën nr. 767/12, datë 03.12.2015, janë rekomanduar 7 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces 2 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

9. BASHKIA MALËSI E MADHE

Nga KLSH me shkresën nr.665, datë 31.03.2016, janë rekomanduar 14 masa organizative, prej tyre se janë zbatuar plotësisht 6 masa, janë në proces zbatimi 6 masa dhe nuk janë realizuar 2 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

10. BASHKIA VAU DEJËS

Nga KLSH me shkresën nr. 642/7, datë 19.11.2015, janë rekomanduar 25 masa organizative të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 20 masa dhe janë në proces zbatimi 5 masa për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

11. BASHKIA LUSHNJË

Nga KLSH me shkresën nr. 242/12, datë 17.06.2016, janë rekomanduar 9 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 6 masa, janë në proces zbatimi 2 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

12. BASHKIA GJIROKASTËR

Nga KLSH janë rekomanduar 35 masa organizative, të cilat janë pranuar, janë zbatuar plotësisht 14 masa, janë zbatuar pjesërisht 8 masa, janë në proces 4 masa dhe janë të pa zbatuara 9 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

13. BASHKIA LIBOHOVË

Nga KLSH janë rekomanduar 17 masa organizative të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 5 masa organizative, janë në proces zbatimi 2 masa, zbatuar pjesërisht 2 masa dhe janë të pa zbatuara 8 masa organizative, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

14. BASHKIA PËRMET

Nga KLSH janë rekomanduar 20 masa organizative, nga të cilat nuk është pranuar 1 masë, janë zbatuar 6 masa, janë në proces zbatimi 4 masa, zbatuar pjesërisht 1 masë dhe nuk janë zbatuar 8 rekomandime, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

15. BASHKIA BERAT

Nga KLSH janë rekomanduar 30 masa organizative të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 8 masa, janë në proces zbatimi 7 masa dhe nuk janë zbatuar 15 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

16. BASHKIA BERAT

Nga KLSH për auditimin e shërbimit parkimit të mjeteve në rrugë janë rekomanduar 9 masa organizative me vlerë **3,718,358 lekë**, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces zbatimi 3 masa në vlerën 3,718,358 lekë, ndërsa nuk është zbatuar 1 masë, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

17. BASHKIA SKRAPAR

Nga KLSH janë rekomanduar 11 masa organizative të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

18. BASHKIA POLICAN

Nga KLSH janë rekomanduar 15 masa organizative të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 9 masa dhe janë në proces zbatimi 6 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

19. BASHKIA MALIQ

Nga KLSH janë rekomanduar 15 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 5 masa, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 9 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

20. BASHKIA POGRADEC

Nga KLSH janë rekomanduar 25 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre është zbatuar plotësisht 1 masë, janë në proces zbatimi 21 masa dhe nuk janë zbatuar 3 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

21. BASHKIA PRRENJAS

Nga KLSH janë rekomanduar 25 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre është zbatuar plotësisht vetëm 1 masë janë në proces 3 masa dhe pa zbatuar 20 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

22. BASHKIA SHIJAK

Nga KLSH janë rekomanduar 27 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar 7 masa, në proces zbatimi 13 masa dhe pa zbatuara 7 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

23. BASHKIA KORÇË

Nga KLSH janë rekomanduar 30 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar 28 masa, në proces zbatimi 2 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Korçë, analiza e mos përdorimit të fondeve me efektivitet, dhe llogaritja e penalteteve në 5 subjekte në vlerën 76,870,080 lekë, për të cilat kanë dalë urdhrat përkatëse, por nuk janë zbatuar.

24. BASHKIA BELSH

Nga KLSH me shkresën nr. 1103/7, datë 05.04.2016 janë rekomanduar 27 masa organizative, prej tyre janë zbatuar plotësisht 17 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, janë në proces 2 masa dhe janë të pa zbatuara 6 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

25. BASHKIA CËRRIK (për ish Komunën Gostimë)

Nga KLSH me shkresën nr. 871/12, datë 17.12.2015 janë rekomanduar 14 masa organizative të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 7 rekomandime, është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, janë në proces 3 rekomandime dhe janë të pa zbatuara 3 rekomandime, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

26. BASHKIA ELBASAN

Nga KLSH me shkresën nr. 129/10, datë 27.5.2016 janë rekomanduar 40 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 28 masa, zbatuar pjesërisht 2 masa, janë në proces 6 masa dhe janë të pa zbatuara 4 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

27. BASHKIA RROGOZHINË

Nga KLSH me shkresën nr. 1193/11, datë 25.4.2016 janë rekomanduar 14 masa organizative të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 8 rekomandime, është zbatuar pjesërisht 1 masë, është në proces 1 masë dhe janë të pa zbatuara 4 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

28. KËSHILLI I QARKUT TIRANË

Nga ana e KLSH me shkresën nr. 572/8, datë 09.09.2016 janë dërguar rekomandimet për 9 masa organizative të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar 5 masa, janë në proces 2 rekomandime dhe janë të pa zbatuara 2 rekomandime, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

29. KËSHILLI I QARKUT DURRËS

Nga KLSH me shkresën nr. 573/8, datë 23.9.2016, janë rekomanduar 11 masa organizative të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 4 masa, janë në proces 4 masa dhe janë të pa zbatuara 3 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

30. PREFEKTI I QARKUT TIRANË

Nga KLSH me shkresën nr. 512/6, datë 10.10.2016 janë rekomanduar 7 masa organizative, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 5 masa, është në proces 1 masë dhe është e pa zbatuara 1 masë, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

31. KËSHILLIN E QARKUT VLORË:

KLSH me shkresën nr. 999/9, datë 22.02.2016 ka rekomanduar 7 masa të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 4 masa dhe janë në proces zbatimi 3 masa për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

32. BASHKIA TIRANË:

a.Për Njësinë Administrative Petrelë (ish-Komunën Petrelë)

KLSH ka rekomanduar 15 masa organizative, të cilat rezultojnë të pashqyrtuara dhe të pazbatuara nga Bashkia Tiranë, prandaj **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

b.Për Njësitë Administrative Pezë dhe Vaqarr

KLSH ka rekomanduar 1 masë organizative e cila nuk është shqyrtuar dhe zbatuar, **prandaj rikërkojmë zbatimin e saj.**

c.Për projektin e infrastrukturor “Ndërtimi, Rikonstruksioni dhe Rinovimi i Unazës së Vogël”.

KLSH ka rekomanduar marrjen e 8 masave organizative, të cilat nuk janë zbatuar, **prandaj rikërkojmë zbatimin e tyre.**

d.Për Drejtorinë e Shërbimit dhe Mbrojtjes nga Zjarri e Shpëtimi, Struktura e cila nga vartësia e Prefekturës Tiranë, ka kaluar në vartësi të Bashkisë Tiranë. KLSH me shkresën nr. 999/9, datë 22.02.2016 i ka rekomanduar Bashkisë Tiranë, marrjen e 3 masave organizative, nga verifikimi rezultoi se rekomandimet e KLSH për këtë auditim nuk janë marrë në shqyrtim nga Bashkia Tiranë, prandaj **rikërkojmë zbatimin e 3 masave organizative të pa realizuara.**

33. BASHKIA MALLAKASTËR

Nga KLSH janë rekomanduar 31 masa, të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 11 masa, janë në proces zbatimi 19 masa dhe pa zbatuar 1 masë, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

34. BASHKIA KONISPOL për ish komunën Markat

Nga KLSH janë rekomanduar 16 masa organizative të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht të 3 rekomandime, 8 rekomandime janë në proces zbatimi dhe janë pa zbatuar 5 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

35. BASHKIA FIER për ish-Komunën Mbrostar

Me shkresën nr. 643/9, datë 26.10.2015 KLSH ka rekomanduar 12 masa të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar plotësisht 9 masa dhe janë në proces zbatimi 3 masa, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e tyre.**

36. BASHKIA VLORË: *Për auditimin e kryer në lidhje me kontratën e koncesionit nr. 496, datë 06.02.2015, me objekt "Dhënia me koncesion e sistemimit dhe menaxhimit të parkimit në qytetin e Vlorës".*

Rekomandimi: *Për auditimin e kryer në lidhje me kontratën e koncesionit nr. 496, datë 06.02.2015, me objekt "Dhënia me koncesion e sistemimit dhe menaxhimit të parkimit në qytetin e Vlorës".* KLSH me shkresën nr. 348/10, datë 30.06.2015 ka rekomanduar 4 masa, nga të cilat janë pranuar në parim, por nga Bashkia Vlorë dhe Këshilli Bashkiak, nuk është kryer revokimi i kontratës së Koncesionit sipas rekomandimit të KLSH.

Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin për sekuestrimin e dokumenteve, datë 08.11.2016, bazuar në kallëzimin penal të paraqitur nga subjekti **lëvizja "Për Vlorën"** ka sekuestruar të gjithë dokumentacionin e procedurës konkurruese dhe te ofertës të koncesionarit në lidhje me kontratën e nënshkruar me operatorët ekonomik [REDAKTUAR] për parkimet në qytetin e Vlorës.

Për këtë arsye Bashkia Vlorë e konsideron të realizuar rekomandimin e KLSH. Por duke qenë se ky kallëzim penal është bërë nga një subjekt jo shtetëror, kërkojmë që të zbatohet rekomandimi i KLSH për revokimin e kontratës koncesionit, pasi kallëzimi penal nuk pezullon nisjen e procedurave për anulimin e kësaj kontrate.

KLSH i qëndron rekomandimit të dhënë me shkresën nr. 348/10, datë 30.06.2015 dhe kërkon nga Drejtoria Juridike Bashkia Vlorë, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore, për të bërë **revokimin e kontratës së koncesionit nr. 496, datë 06.02.2015, me objekt "Dhënia me koncesion e sistemimit dhe menaxhimit të parkimit në qytetin e Vlorës".**

Për arsye se:

-Procesi i përzgjedhjes së ofertuesit fitues nga komisioni i dhënies me koncesion/ppp, është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar dhe VKM nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve/partneritetit publik privat" dhe DSKPP.

-Përmbajtja e kontratës së koncesionit është në kundërshtim me pikën 3 e nenit 27, të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, me ofertën e zgjedhur dhe me njoftimin e dhënies së kontratës, Dokumentet Standarde të Koncesionit Partneritet Publik Privat dhe ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomik të shpallur fitues.

-Llogaritja e tarifës fikse nuk është sipas të dhënave të studimit të fizibilitetit të bërë nga Bashkia dhe afatit kohorë të koncesionit të miratuar me vendim të KB nr. 57, datë 11.12.2014.

a.Rekomandimi: Bashkia Vlorë me procedura ligjore, të revokojë kontratën e koncesionit nr. 496, datë 06.02.2015 me objekt “Dhënia me koncesion e sistemimit dhe menaxhimit të parkimit në qytetin e Vlorës”, deri në miratimin nga Këshilli i Ministrave të listës përfundimtare të kalimit në përdorim apo në pronësi të pasurive të paluajtshme.

b.Rekomandimi: Këshilli Bashkiak Vlorë, pas konstituimit të tij, në mbledhjen e radhës, të marrë në vlerësim e trajtim të gjitha shkeljet e konstatuara nga auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit e të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në përfundim të shprehet lidhur me parregullsinë e vendimeve të mëparshme, të marra nga Këshilli Bashkiak dhe konkretisht të vendimit të KB nr. 45, datë 09.10.2014 dhe nr. 57, datë 11.12.2014.

c.Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë dhe Turizmit, në referim të konstatimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në cilësinë e përfaqësuesit të pronarit shtet, të shprehet duke dhënë opinionin e saj, lidhur me parregullsitë e konstatuara në drejtim të cenimit nga Bashkia Vlorë të së drejtës të pronësisë dhe kufizimit të përdorimit të saj, si pasojë e veprimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe finalizuar me kontratën koncesionare nr. 496, datë 06.02.2015.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Në 38 subjektet e audituara, prej tyre 10 ish-komuna, detyrimet e të cilave janë transferuar në Bashkitë e mëdha, dhe 28 subjekte të evaduara përgjatë periudhës 9/mujorit vitit 2016, konstatohet se nga vlera e rekomanduar për shpërblim dëmi prej **1,883,949 mijë lekë**, janë pranuar dhe janë në proces zbatimi vlera **1,629,013 mijë lekë**, ose ne masën 86 %, duke mos u pranuar apo pa mundësi arkëtimi vlera prej **254,936 mijë lekë**, prej tyre nuk pranohen vlera 15,140 mijë lekë, nga e cila vlera 239,796 mijë lekë, përbëhet nga vlera prej 178,209 mijë lekë, i përket ish-Komunës Velipojë Shkodër, për të cilën janë nxjerrë urdhra për moskontabilizim e veprimeve deri në gjetjen e dokumentacionit të plotë dhe identifikimit të personave. KLSH do rikërkojë përsëri zbatimin e këtij rekomandimi dhe vlera prej 57,787 mijë lekë, pa shpresa arkëtimi në Bashkinë Fushe-Arrëz. Mbeten pa u pranuar nga 10 subjekte vlera prej **15,140 mijë lekë**.

a. Në 28 subjektet e evaduara për gjatë periudhës 9/mujorit 2016, nga vlera e rekomanduar gjithsej prej **1,131,770 mijë lekë**, është pranuar dhe janë në proces zbatimi vlera **1,1058,993** mijë lekë, ose ne masën 94 %, duke mos u pranuar dhe për pasojë mos zbatuar apo pa mundësi arkëtimi vlera prej **72.777 mijë lekë** (nga e cila nuk pranohet vlera 15,140 mijë lekë, dhe vlera 57,787 mijë lekë më pamundësi arkëtimi nga Bashkia Fushk-Arëz, për arsye se subjekti i cili kishte marrë me qira hapësirën publike për Fabrikën është larguar nga Shqipëria).

b. Në 10 Subjektet e audituara për tremujorin e IV-të të vitit 2015, janë rekomanduar në vlerën 752,179 mijë lekë të cilat janë pranuar, prej tyre konsiderohen të realizuara vlera prej 564,165 mijë lekë, ose në masën 75 %, duke mos u realizuar vlera prej 182,009 mijë lekë vlerë e cila është me pamundësi arkëtimi nga kjo vlera 178,209 mijë lekë i përket ish-Komunës Velipojë Shkodër, vlera 3,800 mijë lekë i përket Bashkisë Korçe (pasi nuk mund të vendosen gjoba sepse kanë kaluar afatet ligjore të nxjerrjes vendimeve për IMTV) .

Ndërsa vlera prej 490,220 mijë lekë është në proces gjyqësor, ku vlerën më të madhe prej 423,235 mijë lekë i përket ish-komunës Balldren Lezhë, si pasojë e përdorimit të referencave dhe tarifave të gabuara në dhënien me qira të pasurive komunare, për sipërfaqen prej 4.12 ha dhe 16.65 ha, si dhe tejkallim të kompetencave në dhënien në përdorim pa përcaktuar pagesë, për sipërfaqen prej 29 ha dhe vlera 62,280 mijë lekë, përket ish-Komunës Velipojë Shkodër.

Shënim: Rekomandimet në proces gjyqësor janë konsideruar të realizuara, pasi subjekti ka pranuar detyrimin dhe paraqitja e padive gjyqësore nga cila palë qoftë, kalon në për disa shkallë gjykimi dhe në një periudhë të gjatë kohe si proceset gjyqësore.

Nga vlera e rekomandimeve për të 38 subjektet e audituara prej **1,883,949 mijë lekë**, deri më datën 31.12.2016 **gjendja paraqitet si më poshtë:**

-28 subjekte në vlerën **606,055 mijë lekë**, janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë për kryerjen e ndalesave dhe janë në proces zbatimi.

-23 subjekte në vlerën **99,008 mijë lekë**, janë në proces arkëtimi.

-7 subjektet në vlerën **926,941 mijë lekë** janë në proces gjyqësor civil apo penal, etj, nga të cilët 5 subjekte të 9/mujorit 2016 në vlerën 382,575 mijë lekë dhe 2 subjekte të tremujorit IV-të të vitit 2015 në vlerën 485,515 mijë lekë, nga e cila vlera prej 423,235 mijë lekë përfaqëson detyrimin për qiranë e truallit, apo tarifës së zënies të hapësirës publike, nga një subjekt privat në ish-komunën Balldre, Lezhë.

-13 subjekte nuk i kanë pranuar apo zbatuar plotësisht disa nga rekomandimet e KLSH për vlerën **254,936 mijë lekë**, nga të cilat 3 subjekte për arsye objektive, ndërsa vlera prej **15,140 mijë lekë** nga 10 subjekte nuk pranohet për arsye të ndryshme dhe të pa argumentuara ligjërisht, prandaj KLSH do rikërkojë shpërblimin e dëmit në vlerën **prej 15.140 mijë lekë** si më poshtë:

-Bashkia Përmet për vlerën 1,543 mijë lekë

-Bashkia Lezhë për vlerën 5,276 mijë lekë

-Bashkia Lushnjë në vlerën 3,143,470 lekë

-Bashkia Poliçan në vlerën 1,915 mijë lekë

-Prefektura Tiranë në vlerën 467 mijë lekë

-Këshilli i Qarkut Vlorë për vlerën 429 mijë lekë

Katër subjekte në vlerën **239,796 mijë lekë**, nuk janë me pritshmëri arkëtimi, ku pjesën më të madhe e zë mos arkëtimi i tarifave të zënies së hapësirës për llogari të Bashkisë Fushë-Arrëz, nga ish-pronarët [REDACTED] të ish-Fabrikës Bakrit në vlerën 57,787 mijë lekë, për arsye se është larguar nga Shqipëria dhe është në proces falimentim. Kurse diferenca e tjetër përfaqësojnë vlera e gjobave të IMTV për të cilat nuk mund të nxirren vendimet ekzekutive (dënimet me gjobe) pasi kanë kaluar afatet ligjore, si Bashkia Përmet 400 mijë leke, Poliçan 1,300 mijë lekë dhe Korçë 3,800 mijë lekë.

Në mënyrë më të detajuar masa për shpërblim dëmi për secilën Subjekt paraqitet si më poshtë:

1. BASHKIA FUSHË ARRËZ

Nga verifikimi rezulton se janë pranuar 29 masat e rekomanduara nga KLSH për vlerën **75,765,200 lekë**. Nga masat e pranuar janë në proces zbatimi **26** masa për vlerën **17,978,184 lekë** dhe janë të pa zbatuara **3** masa në vlerën **57,787,016 lekë**, për të cilat rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:

1.1.Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI), të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar vlerën e detyrimit të pa derdhur nga shoqëria ██████████, në shumën **57,693,074 lekë**.

2.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë-Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Iballë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **69,121 lekë** (sigurim i ofertës), nga operatori ekonomik ██████████.

3.1.Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësitë Administrative Qafë Mali dhe Iballë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **24,821 lekë**, nga personat përgjegjës, sipas aneksit 19 dhe 20, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. BASHKIA HAS

Nga KLSH me shkresën nr.241/1, datë 29.08.2016 i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë **23** rekomandime për shpërblim dëmi, në vlerën 21,592,281 lekë, nga verifikimi rezulton se janë në proces zbatimi **22 masa për vlerën 20,866,081 lekë** dhe është pa zbatuar **1 masë me vlerë 736,200 lekë**, për të cilën *rikërkojmë* zbatimin e saj.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Has dhe administratori i Njësisë Administrative Golaj të marrin masa për njoftimin dhe arkëtimin nga 139 persona të cilët nuk kanë paguar vlerën e ujit të pijshëm prej 736,200 lekë, në të kundërtën të kryhet ndërprerja e furnizimit me ujë të pijshëm (*Sipas listave në pikën 6 faqe 87-115 Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

3. BASHKIA BULQIZË.

Nga KLSH me shkesën nr. 574/9, datë 30.09.2016 i janë rekomanduar gjithsej **25 masa shpërblim dëmi për vlerën 59,376,399 lekë** të cilat pranuar, prej tyre është zbatuar plotësisht 1 masë në shumën 76,260 lekë, janë në proces zbatimi 21 masa për shumën 27,566,738 lekë dhe janë të pa zbatuara **3 masa në vlerën 31,733,401 lekë**, për të cilët *rikërkojmë* zbatimin e tyre si më poshtë:

1.1.Rekomandimi:Të merren masa, e të kryhen kontabilizimi dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit me vlerën **21,216,000 lekë**, e cila përfaqëson mungesë të ardhurash nga mos pagesa e qirave të truallit, nga 48 qiramarrës sipas listës në Raportin Përfundimtar të Auditimit faqe 248-260.

2.1.Rekomandimi:Bashkia Bulqizë, të marrë masat, duke ngritur një komision me specialistë të fushës, të identifikojë personat përgjegjës debitorë për mungesën e mjeteve të transportit duke ndjekur inventarizimet në vite deri në origjinën e krijimit të asetit.

Në mungesë të dokumentacionit kontabël ligjor, të merren masat dhe të kërkohet sipas procedurave ligjore, *arkëtimi i vlerës 7,747,689 lekë nga Titullarët e Njësive Vendore dhe Përgjegjëset e Financës:*

z. M.D. me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë Bulqizë, R.B. me detyrë Përgjegjës i Financës Bashkia Bulqizë dhe S.K. ish-Përgjegjës i Financës Bashkia Bulqizë, për mungesën e 3 mjeteve të transportit në vlerën 1,664,543 lekë.

z. F.B. me detyrë ish-Kryetar i Komunës Trebisht, aktualisht Administrator në Njësinë Trebisht dhe K.A. me detyrë ish Përgjegjëse e Financës Komuna Trebisht, për mungesën e 2 mjeteve të transportit në vlerën 2,073,101 lekë.

z. R.R. me detyrë ish-Kryetar i Komunës Ostren dhe Sh.K. me detyrë ish Përgjegjëse i Financës Komuna Ostren, për mungesën e 9 mjeteve të transportit në vlerën 4,010,045 lekë.

33.1.Rekomandimi:Të merren masa, të kryhet kontabilizimi i detyrimit duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore, në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit ekonomik nga OE ██████████ në vlerën **2,769,712 lekë**.

4. BASHKIA MIRDITË

Nga KLSH me shkresën nr. 384/12, datë 15.08.2016 janë rekomanduar **14** masa **shpërblim dëmi** në vlerën **30,666,402 lekë**, nga verifikimi rezulton se prej tyre janë pranuar **13** masa në vlerën 30,555,402 lekë, nuk pranohet **2** rekomandime në vlerën 291,000 lekë, **për të cilën rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:**

1/8.1Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **180,000 lekë** nga ish-kryetari i komunës Kaçinar z. P.D. për përfitim të paligjshëm të bonusit të transportit në masën 15,000 lekë/muaj, për periudhën korrik 2014-korrik 2015.

2/9.1Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **111,000 lekë** për shpenzime për telefonin celular të përfituara tepër, përkatësisht nga ish-punonjësit, N.G. 72,000 lekë, N.D. 30,000 lekë dhe Gj.P. 9,000 lekë.

3/1.1Rekomandim: Bashkia Mirditë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e detyrimeve për qiratë e papaguara për ish-Komunën **Orosh** për vitet 2014 - 2015 për vlerën **272,400 lekë**, sipas listave emërore të pasqyruara në faqet 93 dhe 94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit .

5. BASHKIA KURBIN

Nga Bashkia Kurbin janë pranuar të 16 masat e rekomanduara nga KLSH me shkesën nr. 511/10 datë 23.09.2016, për shpërblim dëmi në vlerën **15,898,797 lekë**, prej tyre janë në proces zbatimi 13 masa për vlerën 15,867,597 lekë dhe të pa zbatuara **2 masa në vlerën 31,200 lekë**, për të cilat rikërkojmë zbatimin e plotë të tyre, **si më poshtë:**

1/9.1- Rekomandim: Të kërkohe në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen *ndalesat në vlerën 13,000 lekë*, për Xh.J. duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

2/10.1- Rekomandim: Të kërkohe në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen *ndalesat në vlerën 18,200 lekë*, K.B. duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

6. BASHKIA SHKODËR (për ish-Komunën Velipojë)

Nga KLSH me shkresën nr.550/11, datë 20.10.2015 ka rekomanduar 19 masa shpërblim dëmi, në vlerën **224.686 mijë lekë**, nga verifikimi rezulton se është zbatuar 1 masë, ndërsa për 18 masat e Për shpërblim dëmi janë në proces gjyqësor për shumën prej 64,668,549 lekë, **prandaj rikërkojmë zbatimin e tyre** dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit, **si më poshtë:**

1.1 (10/1) Rekomandim: vlerën prej **147,082 mijë lekë** nga e cila; vlera prej **75,715 mijë lekë për vitin 2013**, vlera prej **48,999 mijë lekë për vitin 2014** dhe vlera prej **22,568 mijë lekë për 6/mujorin e I-rë viti 2015**, ndaj subjekteve tatimpagues sipas listave *përkatëse të Financës, pasqyruar hollësisht në tabelën emërtuar “Pasqyra e Realizimit te Ardhurave për vitet 2013-2014 dhe 6/muj i-rë 2015 sipas rakordimeve me Degën e Thesarit Shkodër”*.

2.1 (13/1)Rekomandim: Të analizohet e nxirret përgjegjësia për **të ardhura të munguara në vlerën 9,100,000 lekë** ne vendin e quajtur Vilun 4,900,000 lekë dhe në Bunë 4,200,000 lekë, nga mos lidhja e kontratave dhe përdorim i pasaktë i termave ”Vilun Hapësirë”, ne **28 raste**, përkatësisht; nr. 12,19.30,38,43,54,56,58-61,66-77,79,82-85 dhe Termi “Bunë Hapësirë” **24 raste** përkatësisht numrat 93, 96, 98, 114,115,118,123-125,131, 135, 138-141,149-152 dhe 154-158; analitikisht pasqyruar në tabelën emërtuar “Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2013- VILUNI”, “Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2013- BUNA”.

3.1 (14/1) Rekomandim: Të analizohet e nxirret përgjegjësia për të ardhurat e munguara në shumën 4,455,000 lekë ndarë në Vilun 2,598,750 lekë dhe në Bunë 1,856,250 lekë, nga mos lidhja e kontratave dhe përdorimi i pasaktë i termave “Hapësirë Hotelesh” në 11 raste 70, 71, 82, 83, 84, 85 65, 67, 69, 70, 71; Termi “Hapësirë”, (term i papërcaktuar) në 23 raste numrat 4, 6, 7, 9, 10, 13, 15, 20, 34, 36, 37,52,58,64)19,27,29,31,34,46,55,59; 1 rast termi “Hapësirë Kompleksi” dhe 1 rast “Hapësirë Vila 9”, analitikisht pasqyruar në tabelën emërtuar “Kontratat e rërës me afate të reduktuara dhe dëmi ekonomik e të ardhurat e munguara për vitin 2014 Viluni”, “Kontratat e rërës me afate të reduktuara dhe dëmi ekonomik e të ardhurat e munguara për vitin 2014 Buna”.

4.1 (15/1) Rekomandim: Të analizohet e nxirret përgjegjësia për të ardhurat e munguara vlerën 17,572,500 lekë nga mos lidhja e 142 kontratave, të rërës ku aktualisht subjektet i përdorin, analitikisht pasqyruar në tabelën emërtuar, “Kontratat e Rërës Plazh dhe instalim Lodra me afate të Reduktuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2015 VILUN-BUNA”.

B/1. Masa për mos Përdorimin me Efektivitet të Fondeve Publike

Nga 6 masa të rekomanduara janë zbatuar 5 prej tyre dhe rikërkojmë zbatimin e 1 mase si më poshtë:

1.1 (5/1) Rekomandim: Bashkia Shkodër për ish-Komunën Velipojë të marrë masa të analizojë dhe të ndjekë hapat ligjor, dhe të kërkojë shlyerjen e të ardhurave të munguara në vlerën totale 31,127,500 lekë nga keq menaxhimi i resursit të sipërfaqeve ranore.

7. BASHKIA LEZHË

Nga KLSH me shkresën nr. 1105/10, datë 30.04.2016, i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Lezhë, të nxjerrë urdhrat ekzekutive për shpërblimin e dëmit në vlerën 31,116,980 lekë. Nga verifikimi rezultoi se nga shuma e rekomanduar nga KLSH për vlerën 31,116,980 lekë deri më datën 11.11.2016, gjendja paraqitet si më poshtë:

-Janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë, janë kryer veprimet kontabile dhe janë arkëtuar në 3 raste vlera 363,620 lekë.

-Nuk pranohen, nuk janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë dhe nuk janë kontabilizuar vlera 5,276,158 lekë, nga të cilat:

-Nuk pranohet rekomandimi nr. 1, për shpenzim të paligjshëm pritje përcjellje në shumën 100,000 lekë,

-Nuk pranohet rekomandimi nr. 4, për shpenzim të pa argumentuar nuk disponohen dokumenta provë si fotografimi para dhe pas kryerjes të këtij shërbimi, për efekt argumentimi për 2 punonjës të Bashkisë për 232,200 lekë,

-Nuk pranohet rekomandimi nr. 9, pagesa të paligjshme për disa Këshilltarë Bashkisë në shumën 558,900 lekë,

-Nuk pranohet rekomandimin nr. 12, shpërblim dëmi nga anëtarët e KVO, për s`kualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik në vlerën 1,418,063 lekë.

- Nuk pranohet rekomandimi nr.13, shpërblim dëmi nga anëtarët e KVO, për s`kualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik në vlerën 2,706,139 lekë.

- Nuk pranohet rekomandimi nr.16, si pasojë e lidhjes së kontratave me të drejtë përdorimi, pa shuma qiraje për objekte prona të Bashkisë Lezhë në vlerën 260,856 lekë.

Për të cilat rikërkojmë sa vijon:

1.1 (1/1) Rekomandimi: Bashkia Lezhë të arkëtojë vlerën 100,000 lekë për shpenzim të paligjshëm pritje përcjellje, nga 80 persona të bashkisë me nga 1,250 lekë secili, sipas listës bashkëngjitur urdhër shpenzimit nr. 465, datë 13.12.2013.

2.1 (2/1) Rekomandimi: Të arkëtohet vlera 26,000 lekë tvsh (130,000 x 20 %) nga subjekti ■■■, pasi në preventiv dhe situacion është llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, nuk është ndarë veças

vlera e pajisjes pa tvsh dhe veças vlera e pajisjes me tvsh, sipas urdhër shpenzimit nr. 115, datë 12.3.2014.

3.1 (3/1) Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **269,424 lekë** nga subjekti [REDAKTUAR], fondi rezervë 3 %, është përfituar padrejtësisht, pasi kjo vlerë nuk është zërthyer në zëra pune të veçantë, por është mjaftuar me pasqyrimin e vlerës të plotë në preventiv dhe situacionin përfundimtar, çka nuk argumenton se çfarë punimesh janë kryer, sipas urdhër shpenzimeve nr. 84, 85, 87, datë 25.02.2013, nr. 192, datë 08.05.2013 për “*Sistemim bllok II banimi pranë lumit Drin ne krah Faza e pare*”.

4.1 (4/1) Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **232,200 lekë** nga preventivuesi N.P. *116,100 lekë* dhe drejtori i shërbimeve P.L. *116,100 lekë*, për shpenzim të pa argumentuar, sipas urdhër shpenzimit nr. 203 datë 13.5.2013, nr. 410 datë 19.11.2013, pasi transporti dheu dhe mbetje urbane mbulohet nga firma kontraktore, gjithashtu nuk disponohen dokumenta provë si fotografimi para dhe pas kryerjes të këtij shërbimi, për efekt argumentimi.

5.1 (5/2) Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **1,468,440 lekë** nga Njësia e prokurimit N K, N P, N Ll me nga *489,480 lekë për secilin*, pasi pa mbështetje ligjore ka përfshirë zërin “*Transportin e mbetjeve të diferencuara dhe inerte*” në DST, në preventiv, në situacionet e firmës pastrimit 2013, 2014, 2015, kontratën nr. 1720, datë 16.9.2011 dhe shtesën e kontratës nr. 799, datë 02.5.2011.

-Të arkëtohet vlera **91,217 lekë** nga supervizori E.M. pasi ka nënshkruar situacionet për punë të pakryer në zërin “*pastrimi dhe fshirja e sheshit Gjergj Kastrioti te qytetit*”, ku sheshi i është nënshtruar rikonstruksionit për 7 muaj.

6.1 (6/1) Rekomandimi: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **40,074 lekë**, përfituar padrejtësisht nga Shoqëria [REDAKTUAR], si diferencë e çmimit të karburantit të blerë gjatë vitit 2015.

7.1 (7/1) Rekomandimi: Të arkëtohet vlera e mbetur **325,000 lekë**, nga ish-kryetari i Bashkisë z.V T, për përfitim të padrejtë financiar mujor të shërbimit (Bonusit) të transportit për vitin 2014.

8.1 (8/1) Rekomandimi: Të arkëtohet nga V.T. vlera **168,000 lekë** për shpenzime celulare të përfituara tepër, në vitet 2013, 2014 dhe 2015.

9.1 (9/1) Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **558,900 lekë**, pagesa të paligjshme për disa Këshilltarë Bashkisë, të cilët padrejtësisht janë paguar edhe për ditët që nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e KB për periudhën 2013, 2014 dhe 2015, përkatësisht:

Ll.N. 16,200 lekë, A.D. 24,300 lekë, A.V. 16,200 lekë, Gj.N. 16,200 lekë, P.Gj. 32,400 lekë, S.D. 16,200 lekë, A.K. 24,300 lekë, E.S. 24,300 lekë, A.M. 16,200 lekë, H.M. 24,300 lekë, D.R. 16,200 lekë, F.Ll.16,200 lekë, Gj.P. 16,200 lekë, V.M. 16,200 lekë, A.V. 16,200 lekë, T.M. 16,200 lekë, Gj.Gj. 16,200 lekë, L.T. 24,300 lekë, T.U. 24,300 lekë, P.N. 16,200 lekë, P.Gj. 32,400 lekë, A.N. 24,300 lekë, N.N. 24,300 lekë, M.Gj. 16,200 lekë, Gj.N. 16,200 lekë, Gj.B. 16,200 lekë, Gj.N. 8,100 lekë, N.M. 8,100 lekë, Gj.P. 16,200 lekë dhe A.N. 8,100 lekë.

10.1 (10/1) Rekomandimi: Bashkia Lezhë (*Klubi Sporti Besëlidhja*), të arkëtojë vlerën **855,000 lekë**, pagesa të paligjshme mbi kufirin ligjor për vitin 2013, përkatësisht: G.L. 2,000 lekë, D.Xh. 92,000 lekë, V.P. 92,000 lekë, A.D. 32,000 lekë, B.K. 32,000 lekë, F.P. 32,000 lekë, E.M.32,000 lekë, K.D. 10,000 lekë, A.M. 95,000 lekë, S.A. 95,000 lekë, D.D. 95,000 lekë, N.M. 95,000 lekë, I.J. 95,000 lekë, N.N. 95,000 lekë dhe A.K. 21,000 lekë.

11.1 (11/1) Rekomandimi: Bashkia Lezhë (*Klubi Sportit Besëlidhja*), të arkëtojë vlerën **115,600 lekë**, dieta të paligjshme për vitin 2013, nga 43 futbollistë, sipas pasqyrës të raportit auditimit.

12.1 (12/1) Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **1,418,063 lekë**, nga KVO, përkatësisht P.S. 283,612 lekë, B.M. 283,612 lekë, E.N. 283,612 lekë, B.B. 283,612 dhe P.M. 283,612 lekë, për s’kualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik [REDAKTUAR] me ofertën më të ulët, në procedurën e prokurimit me objekt; “*Rikonstruksion i Objektivit 4-katesh në bashkëpronësi sheshi “Besëlidhja” në qytetin e Lezhës*”.

13.1 (13/1) Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **2,706,139** lekë, nga KVO, përkatësisht: P.S. 541,227 lekë, B.M. 541,231 lekë, E.N. 541,227 lekë, B.B. 541,227 lekë, P.M. 541,227 lekë, për skualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik [REDAKTUAR] në procedurën e prokurimit “*Rikualifikim i lulishtes së qendrës së qytetit të Lezhë*”.

14.1 (14/1) Rekomandimi: Të arkëtohet mungesa e të ardhurave nga qeraja për vlerën **2,494,800** lekë nga subjekti [REDAKTUAR], për detyrim kontraktor qiraje të papaguar të ambienteve të Pallatit Kulturës, pronë e Bashkisë Lezhë, për vitet 2013, 2014, 2015.

15.1 (15/1) Rekomandimi: Të arkëtohen detyrimet kontraktore për qiratë e pa paguara të objekteve të Bashkisë Lezhë, për shumën **192,400 lekë dëm ekonomik**, përkatësisht, D.J. 30,000 lekë për vitin 2014 për vitin 2014, E.H. 78,400 lekë, Klubi Ekologjik 50,400 lekë, E.N. 33,600 lekë, për vitin 2015, në të kundërt të ndërpriten kontratat për shkelje të kushteve të tyre.

16.1 (16/1) Rekomandimi: Bashkia Lezhë të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **260,856** lekë, duke lidhur kontratat e qirasë me subjektet [REDAKTUAR] 47,592 lekë, [REDAKTUAR] 36,000 lekë, [REDAKTUAR] 36,000 lekë, [REDAKTUAR] 36,000 lekë, [REDAKTUAR] 36,000 lekë, [REDAKTUAR] 36,000 lekë, [REDAKTUAR] 33,264 lekë.

17.1 (17/1) Rekomandim: Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti [REDAKTUAR], për vlerën **4,113,386** lekë, për punime të pakryera në objektin “*Rikualifikimi i Lulishtes së Qendrës*” Bashkia Lezhë, sipas kontratës për punë publike me nr. 7670/2, datë 17.12.2014.

18.1 (18/1) Rekomandim: Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti [REDAKTUAR], për vlerën **3,059,855** lekë, për punime të pakryera në objektin “*Ndriçimi dhe Sistemimi i Rrugës Hyrëse të Lezhës, Segmenti Ura Drinit-Rotondo*” Bashkia Lezhë, sipas kontratës për punë publike me nr. 2323/2, datë 04.08.2014.

19.1 (19/1) Rekomandim: Bashkia Lezhë, nëpërmjet drejtorisë planifikimin dhe zhvillimit territorit të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për ti kërkuar shoqërisë [REDAKTUAR], arkëtimin e taksës së ndikimit të infrastrukturë të papaguar për vlerën **12,247,743** lekë, për lejen zhvillimore të objektit: “*Godinë Banimi dhe Shërbimi 1-10 kate + 1 kat Podrum Seksioni B-Lezhë*”.

B/1. Masa për mos Përdorimin me Efektivitet të Fondeve Publike:

1.1 Rekomandim: Autoriteti kontraktor dhe njësia e prokurimit të Bashkisë Lezhë, në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit të parashikojë nevojat për prokurim të mallrave apo shërbimeve, të bëj kujdes në përputhje me kërkesat ligjore zgjedhjen e procedurës së prokurimi, llogaritjen e fondit limit (*argumentimin e vlerës limit të kontratës*) dhe përcaktimin e specifikimeve teknike të veçanta në DST, që të bëjë të mundur që KVO të bëjë një vlerësim objektiv dhe jo diskriminues për operatorët pjesëmarrës në procedurat e prokurimit dhe me leverdi ekonomike për fondet buxhetore.

2.1 Rekomandim: Bashkia Lezhë:

a. të ngrejë komision me specialistë të fushës, i cili të bëjë ri llogaritjen e fondit limit, për zërat e punës që nuk janë hartuar sipas manualeve teknike si dhe të bëjë rivlerësimin e diferencave, bazuar në aktet ligjore të kontrollit dhe disiplinimit e punimeve të ndërtimit etj, për objektet “*Rikualifikimi i Qendrës së Qytetit Lezhë*”, “*Rikualifikimi i Lulishtes së Qendrës*” dhe “*Zgjerim i Urës mbi Lumin Drin, Ndriçim dhe Dekorim*”, njëkohësisht bashkia të analizojë shkeljet e personave përgjegjës.

b. ti kërkojë BOE [REDAKTUAR], që të realizojë të gjitha volumet e punës së pakryer duke i pasqyruar dhe dokumentuar ato tërësisht.

a. BASHKIA LEZHË (për detyrimet e Ish-Komunës Balldren i Ri)

Nga KLSH me shkresën nr. 767/12, datë 03.12.2015, janë rekomanduar 11 masa për shpërblim dëmi në shumën **430.121 mijë lekë**, nga të cilat janë pranuar, prej tyre janë zbatuar pjesërisht 10 rekomandime (kontabilizuar e nisur njoftimet), dhe është në proces gjyqësor 1 rekomandim në

shumën 423.235 mijë lekë, për të cilat të cilën rikërkojmë zbatimin e masave të përcaktuara dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit, **si më poshtë:**

1.1 Rekomandimi: Shuma prej **340,008 lekë**, që përbën vlerën e paguar subjekti fizik Gj.S. Balldren pa u kryer hyrja e materialeve të blera në magazinë, pa u nënshkruar fatura dhe dokumentacioni nga komisioni i blerjeve dhe pa u dokumentuar me situacion përdorimi i materialeve, të zhdëmtohet nga personat përgjegjës z. Z.D. me detyrë Kryetari i Komunës e njëkohësisht nëpunës autorizues e urdhërues i pagesës dhe zj. D.P. si nëpunës zbatues me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financës.

2.1 Rekomandimi: Shuma prej **398,862 lekë**, që përbën vlerën e paguar subjekti fizik Gj.S. Balldren pa u kryer hyrja e materialeve të blera në magazinë, pa u nënshkruar fatura dhe dokumentacioni nga komisioni i blerjeve dhe pa u dokumentuar me situacion përdorimi i materialeve, të zhdëmtohet nga personat përgjegjës z. Z.D. me detyrë Kryetari i Komunës e njëkohësisht nëpunës autorizues e urdhërues i pagesës dhe zj. D.P. si nëpunës zbatues me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financës.

3.1. Rekomandimi: Shuma prej **11,353 lekë**, që përbën vlerën sigurimit të ofertës ti mbahet Shoqërisë [REDAKTUAR] për tërheqjen nga prokurimi ku ishte shpallur fitues, me objekt “Sistemim pjesor i kanaleve të ujërave të zeza Balldre Kodër”.

4.1 Rekomandimi: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **23,028 lekë**, përfituar padrejtësisht nga personi fizik Z.Gj. si pasojë e pagesës së kontratave të punëve për sistemimin e ujërave të zeza, kur subjekti nuk i nënshtrohet tvsh-së.

5.1 Rekomandimi: Shuma prej **49,830 lekë**, që përbën vlerën e paguar subjekti fizik Sh.P. për blerje të artikujve pije freskuese e alkoolike, pa u kryer hyrja e materialeve të blera në magazinë, pa u nënshkruar fatura dhe dokumentacioni nga komisioni i blerjeve dhe pa u dokumentuar me program pritje përcjellje, të zhdëmtohet nga personat përgjegjës z. Z.D. me detyrë Kryetari i Komunës e njëkohësisht nëpunës autorizues e urdhërues i pagesës dhe zj. D.P. si nëpunës zbatues me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financës.

6.1 Rekomandimi: Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri, të marrë masa dhe të ngrejë grup pune për të analizuar të gjitha veprimet administrativo-procedurale duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **883,545 lekë**, nga z. Gj.D. si tërheqës i sasisë së karburantit dhe personat e tjerë përgjegjës që përbën vlerën e 5011.5 litra karburant të tejkaluara nga normativa e miratuar me vendim të ish-Këshillit të Komunës Balldren i Ri.

7.1 Rekomandimi: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **300,000 lekë**, nga z. Z.D. ish-Kryetar i Komunës Balldren i Ri, përfituar në kundërshtim me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”.

8.1 Rekomandimi: Nga Njësia Administrative Balldren i Ri, Bashkia Lezhë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,334,673 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik [REDAKTUAR], në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 347, datë 01.07.2013 “Rikonstruksion (Sistemim-Asfaltim) i Rrugës Balldren-Torovicë loti I-rë”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

9.1 Rekomandimi: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **1,844,614 lekë**, nga këshilltarët e Komunës Balldren i Ri si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Mungesa në ditë	Totali	Nr	Emër Mbiemër	Mungesa në ditë	Totali
1	T.K.	12	83,316	11	S.D.	14	97,176
2	R.S.	17	117,620	12	V.L.	16	111,313
3	E.M.	15	103,933	13	Z.M.	20	138,237

4	H.Gj.	14	97,003	14	Z.N.	17	118,243
5	K.M.	14	97,003	15	Z.N.	13	90,246
6	L.L.	14	103,933	16	Gj.S.	13	90,540
7	Gj.Gj.	13	131,307	17	Gj.F.	11	76,680
8	Gj.M.	16	111,036	18	A.K.	5	34,581
9	P.R.	16	110,863	19	P.Ç.	6	41,338
10	P.Gj.	13	90,246	TOTALI	259	1,844,614	

10.1 Rekomandimi: Bashkia Lezhë (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Balldren), ti kërkoj zyrtarisht operatori privat mobile [REDAKTUAR], shlyerjen e detyrimit me dëm ekonomik krijuar buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën prej **1,700,000 lekë** (4 mujori 2012, $500 \text{ m}^2 \times 100 \text{ lekë/m}^2 \text{ muaj} = 200,000 \text{ lekë}$, sipas VKM nr. 529, datë 08.6.2011, vlera për 12 mujori 2013, $500 \text{ m}^2 \times 100 \text{ lekë/m}^2 \text{ muaj} = 600,000 \text{ lekë}$, vlera prej 12 mujori 2014, $500 \text{ m}^2 \times 100 \text{ lekë/m}^2 \text{ muaj} = 600,000 \text{ lekë}$, dhe vlera për 6 mujori 2015, $500 \text{ m}^2 \times 100 \text{ lekë/m}^2 \text{ muaj} = 300,000 \text{ lekë}$), pasojë e përdorimit të territorit pa pasur një kontratë qiraje. Po ashtu ti kërkoj shoqërisë, lidhjen e kontratës duke mbuluar periudhën nga data 29.08.2012.

11.1 Rekomandimi: Bashkia Lezhë në të cilën përfshihet njësia Administrative Balldren i Ri, të marrë masa dhe të ngrejë grup pune për të negociuar kontratën me operatorin [REDAKTUAR]. Njëkohësisht ti kërkoj zyrtarisht operatorit [REDAKTUAR], pagesën e shumës prej **423,235,000 lekë**, dëm ekonomik krijuar buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përdorimit të referencave dhe tarifave të gabuara në dhënien me qira të pasurive komunare, për sipërfaqen prej 4.12 ha dhe 16.65 ha, si dhe tejkalim të kompetencave në dhënien në përdorim pa përcaktuar pagesë, për sipërfaqen prej 29 ha, **në të kundërt çështja të ndiqet zyrtarisht në gjykatë.**

8. BASHKIA FIER (për ish-Komunën Mbrostar).

KLSH me shkresën nr. 643/9, datë 26.10.2015, ka rekomanduar 14 masa shpërblimi në **vlerën 5,690,972 lekë**, nga verifikimi rezultoi se janë zbatuar pjesërisht 4 masa, janë në proces zbatimi 8 masa dhe nuk janë realizuar 2 masa për shpërblim dëmi për **të cilën rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:**

1.Rekomandimi: Bashkia Fier, ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të marrë masa dhe të kryej arkëtimin e vlerës **1,535,074 lekë**, për pagesa të paligjshme, nga këshilltarët: B.Z. 70,210 lekë, G.K. 126,523 lekë, L.M. 91,679 lekë, L.G. 70,214 lekë, R.K. 70,214 lekë, N.B. 83,728 lekë, B.R. 84,524 lekë, S.B. 70,214 lekë, Sh.G. 84,126 lekë, Sh.H. 98,834 lekë, S.V. 119,766 lekë, E.K. 105,854 lekë, H.V. 70,214 lekë, T.B. 119,766 lekë, L.G.70,214 lekë, L.H. 99,495 lekë dhe K.B. 99,495 lekë.

2.Rekomandimi: Bashkia Fier, ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të marrë masa dhe të analizojë në Këshillin Bashkiak këto pagesa dhe pas vendimit të kryhen veprimet përkatëse për sistemimin e vlerës **109,500 lekë**, duke kërkuar arkëtimin e kësaj vlere.

3.Rekomandimi: Bashkia Fier, ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të kërkojë shpërblimin e dëmit në **vlerën 1,282,488 lekë** nga z. P.V. në vlerën 738,398 lekë, z.Sh.Xh. në vlerën 156,102 lekë, z.L.H. në vlerën 148,563 lekë, z. L.D. në vlerën 117,410 lekë dhe z. V.T. për vlerën 75,000 lekë.

4.5 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues të marrë masa dhe të nxjerrë aktet administrative dhe të ndiqen rrugët ligjore, për kërkimin e shpërblimit të dëmit për **8 raste** në vlerën **487,764 lekë** për: J.Th. Fadromist, për vlerën 242,103 lekë, Q.M. në vlerën 68,461 lekë, A.M. shofer në vlerën 80,100 lekë, E.B. në vlerën 4,600 lekë, P.Dh. në vlerën 22,208 lekë, H.Xh. shofer në vlerën 31,771 lekë dhe S.Sh. magazinier në vlerën 7,200 lekë.

6. Rekomandimi: Bashkia Fier, ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin për vlerën për **74,400 lekë** e pakësuar në postin e llogarisë 215 "Mjete transporti", të bilancit të vitit 2014, ç'ka ngarkon me znj. N.S. me detyrë përgjegjëse e zyrës së financës dhe z. A.G. si posedues i motoçikletës me vlerë **37,200 lekë** secili.

7.Rekomandimi: Bashkia Fier, ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të kërkojë arkëtimin e detyrimit nga personat përgjegjës,përkatësisht: *znj. N.S. për vlerën 1700 lekë, R.K. për vlerën 1700 lekë, F.G. për vlerën 1700 lekë dhe S.L. për vlerën 1700 lekë.*

8.Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Fier ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **894,878 lekë**, nga bashkimit i operatorëve ekonomik [REDAKTUAR], paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Ngritje Terreni sportiv fshati Petrovë”.

9.Rekomandim: Nga Komuna Mbrostar të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **107,004 lekë** pa TVSH nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 302/13, datë 03.06.2014 me objekt: “Rikonstruksioni i linjës kryesore të ujit të pijshëm Vajkan”, për vitin 2014, Komuna Mbrostar, Rrethi Fier, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

10.14.Rekomandim: Nga Bashkia Fier ku bën pjesë Njësia administrative Mbrostar të kontabilizojë dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **45,473 lekë** nga punonjësit: *E.L. në vlerën 11,368 lekë, B.Dh. në vlerën 11,368 lekë, N.S. në vlerën 11,368 lekë, L. Ç. në vlerën 11,368 lekë.*

9. BASHKIA MALËSI E MADHE

Nga KLSH me shkresën nr. 665, datë 31.03.2016, i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe **për shpërblimin e dëmit në vlerën 18,441,036 lekë**. Nga verifikimi rezultoi se nga shuma e rekomanduar nga KLSH për vlerën 18,441,036 lekë, janë nxjerr urdhrat ekzekutivë, janë kontabilizuar në 5 raste vlera 2,150,046 lekë, Pranohen, janë nxjerr urdhrat ekzekutivë por nuk është kontabilizuar vlera 16,290,990 lekë, **prandaj rikërkojmë zbatimin e tyre, si më poshtë:**

1.1 (1/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të analizojë shkaqet e likuidimit të shpenzimeve të telefonisë së lëvizshme (celular) me vlerë **455,129 lekë**, pa përfunduar procesi gjyqësor i hapur, të nxjerrë përgjegjësitë për veprimin e kryera në shkelje të disiplinës financiare të fondeve të Buxhetit, duke përcaktuar efektet për çdo punonjës ose ish-punonjës të Bashkisë Koplík (sot Bashkia Malësi e Madhe).

2.1 (3/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **379,974 lekë**, *ndaj punonjësve:*

-**Znj. E.Z. për vlerën 113,677 lekë**, në cilësinë e kryetarit të Kom. Blerjeve të vogla.

-**Znj. N.D. për vlerën 63,460 lekë**, në cilësinë e anëtarit të Kom. të blerjeve të vogla.

-**Znj. A.I. për vlerën 126,658 lekë**, në cilësinë e anëtarit të Kom. të blerjeve të vogla.

3.1 (4/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **366,000 lekë**, *ndaj personave:* A.L. në vlerën 21,000 lekë, A.B. në vlerën 12,000 lekë, B.M. në vlerën 21,000 lekë, B.C. në vlerën 12,000 lekë, B.P. në vlerën 12,000 lekë, D.M. në vlerën 12,000 lekë, E.Z. në vlerën 21,000 lekë, E.K. në vlerën 21,000 lekë, E.D. në vlerën 12,000 lekë, E.L. në vlerën 21,000 lekë, E.P. në vlerën 21,000 lekë, F.M. në vlerën 12,000 lekë, G.Gj. në vlerën 21,000 lekë, I.O. në vlerën 21,000 lekë, K.Z. në vlerën 12,000 lekë, K.K. në vlerën 21,000 lekë, N. D. në vlerën 9,000 lekë, S.H. në vlerën 21,000 lekë, T.N. në vlerën 21,000 lekë, V.P. në vlerën 21,000 lekë dhe Xh.P. në vlerën 21,000 lekë.

4.1 (5/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **59,000 lekë**, *ndaj punonjësve:*

-Znj. E.Z. për vlerën 19,800 lekë, në cilësinë e kryetarit të komisionit të blerjeve të vogla.

-Znj. N.D. për vlerën 19,600 lekë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla.

-Znj. A.I. për vlerën 19,600 lekë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla.

5.1 (7/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **479,615 lekë**, në ngarkim të **I.R.** me detyrë ish-Kryetar i Komunës Qendër.

6.1 (8/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **396,900 lekë**, ndaj punonjësve:

-Z. B.B. për vlerën 97,881 lekë, në cilësinë e kryetarit të komisionit të blerjeve të vogla.

-Z. P.M. për vlerën 132,300 lekë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla.

-Z. A.M. për vlerën 102,235 lekë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla.

7.1 (9/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **332,098 lekë**, në ngarkim të **V.P.** me detyrë ish-Kryetar i Komunës Kastrat.

8.1 (10/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **378,949 lekë**, ndaj punonjësve:

Z. V.P. për vlerën 189,475 lekë, me detyrë ish-Kryetar i Komunës Kastrat.

Z. B.B. për vlerën 189,475 lekë, me detyrë ish-P/Zyrës së Financës, Komuna Kastrat.

9.1 (11/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **772,800 lekë**, ndaj punonjësve:

-Z. Xh.B. për vlerën 143,082 lekë, në cilësinë e kryetarit të KVO.

-Znj. I.R. për vlerën 83,766 lekë, në cilësinë e anëtarit të KVO.

-Z. A.R. për vlerën 82,176 lekë, në cilësinë e anëtarit të KVO.

-Z. Xh.D. për vlerën 154,560 lekë, në cilësinë e anëtarit të KVO.

-Znj. V.Z. për vlerën 140,027 lekë, në cilësinë e anëtarit të KVO.

10.1 (12/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **637,956 lekë**, ndaj punonjësve:

-Z. R.S. për vlerën 212,652 lekë, në cilësinë e kryetarit të KVO.

-Z. F.B. për vlerën 212,652 lekë, në cilësinë e anëtarit të KVO.

-Znj. E.Z. për vlerën 212,652 lekë, në cilësinë e anëtarit të KVO.

11.1 (13/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa dhe të analizojë shkaqet e mos zbatimit të afateve për punimet e kontratarar, të vlerësojë marrëdhënien juridike me subjektin, duke nxjerrë përgjegjësitë ligjore dhe financiare për diferencat e penaliteteve dhe të kërkojë arkëtimin për ditë vonesat nga subjekti [REDAKTUAR], në vlerën **6,800,757 lekë**.

12.1 (14/1) Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore, të marrë masa për saktësimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit të taksës së ndërtese në **21 subjekte me vlerë 987,750 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore (*Sipas pasqyrës aneks nr. 5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar Auditimit*).

13.1 (15/1) Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore, të marrë masa për saktësimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit të taksës së reklamës në **7 subjekte me vlerë 3,122,550 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore (*Sipas pasqyrës aneks 6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 (16/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për lidhjen e kontratës së qiradhënies sipas legjislacionit në fuqi, duke saktësuar, kontabilizuar dhe arkëtuar detyrimet e qirasë në vlerën **439,200 lekë**, nga shfrytëzimi i pronës publike të Bashkisë ose lirimin nga shfrytëzimi i padrejtë.

15.1 (17/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **6,905 lekë**, në ngarkim të punonjësit **Q.I.** me detyrë llogaritar arkëtar.

16.1 (18/1)Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **852,943 lekë** (pa tvsh) nga bashkimi i operatorëve ekonomik [REDACTED] në cilësinë e sipërmarrësve sipas kontratës nr. 50, datë 13.10.2014.

17.1 (19/1) Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **1,780,125 lekë** (pa tvsh) nga operatori ekonomik [REDACTED] në cilësinë e sipërmarrësit sipas kontratës nr. 703, datë 10.12.2012.

B/I. MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1.1 Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë të fondeve publike, për 2 procedurat e prokurimeve me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **4,878,000 lekë**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

10. BASHKIA VAU-DEJËS

Nga KLSH me shkresën nr. 642/7, datë 19.11.2015, i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, të nxjerrë urdhrat ekzekutive për shpërblimin e dëmit në vlerën **34,639,013 lekë**. Nga verifikimi rezultoi se nga shuma e rekomanduar nga KLSH për vlerën 34,639,013 lekë deri më datën 18.11.2016, janë në proces arkëtimi shuma prej 2,015,535 lekë, për të cilat rikërkojmë vazhdimin e procedurave ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit dhe arkëtimin e detyrimeve të pa zbatuara si më poshtë:

1.1 (2/1) Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **269,700 lekë** nga **personi fizik P.D.** të përfituar padrejtësisht mbi çmimet e miratuara për shërbimin “shpim pusi”.

2.1 (4/1) Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **700,696 lekë** nga Shoqata [REDACTED], përfituar padrejtësisht për pune të pakryer për shërbimin e transportit dhe depozitimit të mbeturinave urbane.

3.1 (5/1) Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa për ndjekjen e procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e sigurimit të ofertës nga subjekti [REDACTED] në vlerën **23,359 lekë**, i cili është tërhequr nga zhvillimi i tenderit me objekt “Ndërtim trotuari fshati Rranxa” ditën e zhvillimit të tenderit datë 24.06.2015, ose në të kundërt të zhëdmtohet nga anëtarët e KVO në mënyrë proporcionale.

4.1 (6/1) Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e dëmit në mënyrë solidarë në vlerën **1,244,100 lekë** nga: **Z.H. ish kryetari i Komunës**, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe nënshkrues i kontratës, **J.M. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit** dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues, vlerë e cila i përket kontratave shtesë mbi kontratat bazë të viteve 2013 dhe 2014.

5.1 (7/1) Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet njësi administrative Bushat të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga operatori ekonomik [REDACTED] të shumës prej **13,130 lekë**, vlerë që i përket sigurimit të ofertës

6.1 (10/1) Rekomandim: Bashkia Vau-Dejës, në të cilën përfshihet Njësia Administrative Bushat, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të pashlyera në shumën **264,550 lekë** nga **26 përdoruesit** të ngastrave të marra me qira nga fondi i pyjor e kullosor pronë e Komunës (*Trajtuar më hollësisht faqen 114-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11. BASHKIA LUSHNJË

Nga KLSH me shkresën nr. 242/12, datë 17.06.2016, i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Lushnjë të nxjerrë aktet administrative përkatëse **për shpërblimin e dëmit në vlerën 10,631,933 lekë**. Nga verifikimi rezultoi se nga shuma e rekomanduar nga KLSH për vlerën **10,631,933 lekë**, deri më datën 22.11.2016 gjendja paraqitet si më poshtë:

-Janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë, janë kontabilizuar vlera prej **7,788,463 lekë**
- Nuk janë kontabilizuar pasi nuk janë pranuar rekomandimet shuma prej **3,143,470 lekë, nga të cilat:**

-Nuk pranohet rekomandimin nr. 1, për shpërblim për punë të pakryer nga këshilltarët e ish Bashkisë Lushnjë, për vlerën 1,552,100 lekë.

-Nuk pranohet rekomandimi nr. 2, për shpërblim për punë të pakryer nga këshilltarët e ish Komunës Golem, për vlerën 654,750 lekë.

-Nuk pranohet rekomandimi nr. 10, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera nga shoqëria [REDAKTUAR] për vlerën 936,629 lekë.

KLSH nuk i pranon argumentimet e paraqitura nga Bashkia Lushnjë dhe rikërkon shpërblimin e dëmit në vlerën 10.631.933 lekë, si më poshtë:

1.1 (1/1) Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit për shpërblim për punë të pakryer, në **vlerën 1,552,100 lekë**, nga ish-anëtarët e Këshillit Bashkiak, Lushnjë, sipas aneksit nr. 1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1 (2/1) Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit për shpërblim për punë të pakryer, (mos marrje pjesë në mbledhje) në vlerën **654,750 lekë**, nga ish-anëtarët e Këshillit Bashkiak, Lushnjë, sipas aneksit nr. 1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.1 (4/1) Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në **vlerë 470,502 lekë** nga shoqëria [REDAKTUAR], detyrim i pa llogaritur dhe i pa arkëtuar, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit nr. 3196, datë 14.08.2014 me objekt: “Godinë banimi dhe shërbimi 5,7,10 kate + 1 kat nëntokë (3kt njësi shërbimi + 7kt banimi + 1kt nën tokë)” (*trajtuar në detaje në faqet nr. 149-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 (5/1) Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë **1,790,604 lekë** nga shoqëria [REDAKTUAR] detyrim i pa llogaritur dhe i pa arkëtuar, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit nr. 174/3, datë 29.6.2015, miratuar nga ish-Komuna Golem, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë, Lushnjë, me objekt “Kapanone metalike të çmontueshme për mirëmbajtjen e mjeteve bujqësore dhe magazinë për mbajtjen e prodhimeve bujqësore” (*trajtuar në detaje në faqet nr. 156-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

5.1 (7/1) Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në për mos llogaritje dhe arkëtim të tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave, për çdo kantier ndërtimi, nga bashkimi i shoqërive [REDAKTUAR] në shumën 70,000 lekë; nga shoqëria [REDAKTUAR] në shumën 70,000 lekë; nga shoqëria [REDAKTUAR], në shumën 210,000 lekë; dhe nga shoqëria [REDAKTUAR] në shumën 70,000 lekë (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 (8/1) Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerën **3,957,579 lekë** (pa tvsh) nga shoqëria [REDAKTUAR], nga të cilat shuma prej 2,405,963 lekë në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4311, datë 14.07.2015 me objekt “Rehabilitimi i Fasadave në Qendër të Qytetit dhe në Rrugën “Misto Mane”, Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera, të trajtuara më hollësisht në faqet nr. 116-147 të Raportit të Auditimit dhe, shuma prej 1,551,615 lekë, nga të cilat vlera prej **1,293,600 lekë** për punime të pakryera të likuiduara dhe vlera prej **258,015 lekë** si pasojë e dëmeve të likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike datë 15.06.2015 me objekt: “Shtrimi i Rrugëve Bujqësore me Çakull dhe Rikompozim i Lulishtes Bubullimë”, ish-Komuna Bubullimë, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë, Lushnje (trajtuar në detaje në faqet nr. 101-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 (9/1)Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë **537,390 lekë** (pa tvsh), nga shoqëria [REDAKTUAR] nga të cilat (1) shuma prej 248,400 lekë në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4015 prot., datë 19.06.2015 me objekt “Rikontruksioni i Rrugës “Vasil Bello””, Bashkia Lushnje, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera, të trajtuara në detaje në faqet nr. 116-147 të Raportit të Auditimit; (2) shuma prej 156,750 lekë, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3822 prot., datë 09.06.2015 me objekt “Sistemim Asfaltim i Rrugës “Abdyl Korreshi””, Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera, të trajtuara në detaje në faqet nr. 116-147 të Raportit të Auditimit dhe (3) shuma prej 132,240 lekë , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3840 prot., datë 11.06.2015 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës “Idriz Seferi”” Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera (trajtuar në detaje në faqet nr. 116-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 (10/1)Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë **936,620 lekë** (pa tvsh) nga shoqëria [REDAKTUAR] në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4581 prot., datë 19.11.2014 me objekt “Restaurimi i Ndërtesës ku u mbajt Kongresi i Leshnjës”, Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera, të trajtuara në detaje në faqet nr. 116-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

12. BASHKIA GJIROKASTËR

KLSH me shkresën nr. 266/8, datë 26.12.2016, nga 7 masa **shpërblim dëmi** të rekomanduara në vlerën **14,071,908 lekë**, janë pranuar nga Subjekti, është bërë njoftimi i personave debitorë por nuk janë kryer regjistrimet kontabile, janë në proces zbatimi për vlerën 13,974,988 lekë. Nuk janë bërë kërkesë padë në gjykatë për arkëtimin e detyrimeve për vlerën 13,974,988 lekë, për të cilat **rikërkojmë ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre si më poshtë:**

1/1.1.Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër të marrë masa të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **1,217,578 lekë**, sa përfituar më tepër nga 25 anëtarët e këshillit sipas listës nr. 3, bashkëlidhur.

2/2.1. Rekomandim: Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 5,608,357 lekë, nga OE [REDAKTUAR] e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaltiteteve, në tenderin me objekt “Ndërtim i rrugës: Unaza Granicë-Gerhot faza IV” .

3/3.1. Rekomandim: Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 2,835,679 lekë, nga Operatori Ekonomik [REDAKTUAR] e cila përfaqëson shumën e

moszbatimit të penaliteteve për 92 ditë vonesa, në tenderin me objekt “Ndërtim i rrugës: Unaza Granicë - Gerhot faza IV” .

4/4.1. Rekomandim: Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 402,320 lekë, nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaliteteve përkatësisht 45 dhe 62 ditë vonesa, në tenderin me objekt “Blerje kazanë metalik 1100 L për mbetjet urbane”.

5/5.1.Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastrë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **141,440 lekë**, ngabashkimi i operatorëve ekonomik [REDAKTUAR] paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Projekte në Parkun e Viroit: Sistemim i Parkut të Viroit, Rikonstruksion i rrugës në Parkun e Viroit, Ndriçim i trotuarit nga ana e qytetit”.

7/7.1. Rekomandim: Vlera prej **3,391,534 lekë**, nga kërkuesit e lejeve të përdorimit sipas Aneksit Nr. 1, bashkëlidhur, për arsye se, vlera e ndërtimit të objektit sipas preventivit të paraqitur nuk është llogaritur, duke u bazuar në manualet teknike të çmimit të punimeve të ndërtimit të miratuara me VKM-në përkatëse ose çmimit për m2 sipërfaqe ndërtimi të përcaktuara nga EKB.

8/1.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike, për *10 procedurat* e prokurimeve me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **12,195,169 lekë**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit (*referuar pasqyrimin të hollësishëm në Aneksin 1 e 2 bashkëlidhur vendimit*).

13. BASHKIA LIBOHOVË

Nga 22 masa për zhvendim të demit të rekomanduara me shkresën e KLSH nr. 509/9, datë 22.09.2016, për vlerën totale **12,512,551 lekë të cilat** janë pranuar, prej tyre janë në proces zbatimi 18 masa për zhvendim të demit, 2 masa janë zbatuar pjesërisht për vlerën 968 mijë lekë dhe 2 masa nuk janë zbatuar dhe **duke mbetur në proces zbatimi vlera 11,545 551 lekë**, për të cilat **rikërkojmë** zbatimin e tyre si më poshtë:

1/1.1 Rekomandimi: Vlera **1,266,800 lekë** gjithsej e cila përbën detyrimin për 6 kontratat e qirasë së kullotave të kontabilizohet si detyrim dhe të zhvendtohet nga **6 qiramarrësit si vijon:**

1.F.C. në vlerën **369,800 lekë**, pasi në ekonominë kullimore Zagori, në parcelën nr. 62, J.F.K Çajup, sipas kontratës për periudhën nga 01.06.2013-30.11.2013 duhet të paguante vlerën **199,800 lekë** dhe kontratës datë 05.06.2013 në vlerën **170,000 lekë** ose gjithsej detyrimi për të dy kontratat për vitin 2013 në vlerën **369,800 lekë**, të cilën nuk e ka paguar.

2. B.B. në vlerën **222,000 lekë** pasi në ekonominë kullimore Zagori, në parcelën nr. JFK Çajup, ka lidhur kontratë për periudhën nga 01.06.2013-30.11.2013, ku rezulton se nuk ka paguar detyrimin në vlerën **222,000 lekë**.

3. I.N. në vlerën **240,000 lekë** pasi, në ekonominë kullimore Zagori, në parcelën JFK, Çajup sipas kontratës nr. 136, datë 03.06.2014 ku rezulton se nuk ka paguar detyrimin në vlerën **240,000 lekë**.

4. Th.G. në vlerën **156,000 lekë** pasi në ekonominë kullimore Zagori, në parcelën nr. 51, Çajup, ka lidhur kontratë qiraje për periudhën 3 vjeçare nga data 01.06.2014-30.11.2016 në vlerën 234,000 lekë, nga të cilat ka arkëtuar me mandat arkëtimin nr. 12, datë 06.06.2014 vlerën 78,000 lekë, duke mbetur pa paguar detyrimin në vlerën **156,000 lekë**.

5. Sh.H. në vlerën **139,000 lekë** pasi, në ekonominë kullimore Zagori, parcelën nr. 54,55,56, Hija e mallkuar, ka lidhur kontratë qiraje për periudhën 3 vjeçare nga data 01.06.2014-30.11.2016, në vlerën 208,500 lekë, nga të cilat ka arkëtuar me mandat arkëtimin nr. 13, datë 06.06.2014 vlerën 69,500 lekë, duke mbetur pa paguar detyrimin në vlerën **139,000 lekë**.

6. A.B. në vlerën **140,000 lekë** pasi, në ekonominë kullosore Zagori, në parcelën nr. 30,31,32,33 Rrëza Topovë, ka lidhur kontratë qiraje për periudhën 3 vjeçare nga data 01.06.2014-30.11.2016, në vlerën 210,000 lekë, nga të cilat ka arkëtuar me mandat arkëtimin nr. 14, datë 10.06.2014 vlerën 70,000 lekë, duke mbetur pa paguar detyrimin në vlerën **140,000 lekë**.

2/2.1 Rekomandimi: Bashkia Libohovë të kontabilizojë detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **1,034,454 lekë**, për mospjesëmarje në mbledhje, nga 16 ish anëtarët e këshillit bashkiak dhe 22 ish anëtarët e këshillit të komunave.

3/3.1 Rekomandimi: Vlera **499,852 lekë**, që përbën diferencën e fondit limit të llogaritur më tepër, të kontabilizohet si detyrim dhe zhdëmtohet nga operatori ekonomik [REDACTED].

4/4.1 Rekomandimi: Vlera **476,217 lekë**, që përbën detyrimin për vonesa në dorëzimin e punimeve të kontabilizohet si detyrim dhe të zhdëmtohet nga **operatori ekonomik** [REDACTED].

5/5.1 Rekomandimi: Vlera **474,711 lekë**, që përbën diferencën e fondit limit të llogaritur më tepër, të kontabilizohet si detyrim dhe zhdëmtohet nga përfituesi operatori **ekonomik** [REDACTED].

6/6.1 Rekomandimi: Të kontabilizohet detyrimi **327,000 lekë** dhe të kërkojë me të gjitha rrugët e mundshme ligjore zhdëmtimi nga ish Titullari i institucionit z. G.K. dhe anëtarët e KBV-së E.T. A.Ll. e A.B. në vlerën 81,750 lekë secili.

7/7.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e pagesës së tepërt nga operatori ekonomik [REDACTED] në vlerën **163,504 lekë**.

8/8.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga 7 punonjësit përfitues në vlerën **156,000 lekë**, si më poshtë:

-G.K. në vlerën 30,000 lekë, Th.K. në vlerën 39,000 lekë, E.Ç. në vlerën 30,000 lekë, F.Z. në vlerën 27,000 lekë, A.M. në vlerën 9,000 lekë, A.B. në vlerën 12,000 lekë, A.B. në vlerën 9,000 lekë.

9/9.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e pagesës së tepërt nga operatori ekonomik [REDACTED] në vlerën **125,185 lekë**.

10/10.1 Rekomandimi: Vlera **119,416 lekë**, që përbën detyrimin për vonesa në dorëzimin në afat të autoveturës të kontabilizohet si detyrim dhe të kërkojë zhdëmtimi nga operatori ekonomik [REDACTED].

11/11.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga zj. L.M. dhe zj.E.Ç. në vlerën **58.755 lekë** secila.

12/12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e pagesave të tepërta kryer me certifikatë lindjeje të pavlefshme nga 22 persona në vlerën **110,000 lekë**.

13/13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti A.Ç. në vlerën **97,820 lekë**.

14/14.1 Rekomandimi: Bashkia Libohovë të kontabilizojë detyrimin prej **80,190 lekë** dhe të kërkojë me të gjitha rrugët e mundshme ligjore arkëtimin e saj, prej së cilës **45,450 lekë** nga zj. A.B. dhe **34,740 lekë** nga z. Th.K.

15/15.1 Rekomandimi: Bashkia Libohovë të kontabilizojë dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimin e dëmit në vlerën **65,321 lekë** gjithsej nga tre ish titullarët si më poshtë:

-A.Ç. në vlerën **24,671 lekë**, G.K. në vlerën **20,325 lekë** dhe A.M. në vlerën **20,325 lekë**.

16/16.1 Rekomandimi: Vlera **36,047 lekë gjithsej**, që përbën dëm të shkaktuar nga dorëzimi me vonesë i punimeve në dy objekte, të kontabilizohet si detyrim dhe të kërkojë zhdëmtimi nga operatori ekonomik përfitues [REDACTED].

17/17.1 Rekomandimi: Vlera **35,000 lekë**, që përbën pagesë të punimeve të pa kryera, të kontabilizohet si detyrim dhe të kërkohet zhdëmtimi nga operatori ekonomik përfitues [REDACTED].

18/18.1 Rekomandimi: Vlera **10,534 lekë**, që përbën diferencën midis ofertës së operatorit ekonomik që duhej të shpallej fitues, por të skualifikuar dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues në mënyrë të pa rregullt, të kontabilizohet si detyrim dhe zhdëmtohet nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, respektivisht z. V.Gj. z. P.M. e zj. V.T. në vlerën 3,512 lekë secili.

19/19.1 Rekomandimi: Nga Zyra e Financës dhe Taksave Vendore të Bashkisë Libohovë të merren masa për regjistrimin në kontabilitet si debitorë në vlerën **17,685,000 lekë** gjithsej, të krijohet regjistri elektronik, të merren masa për arkëtimin dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore për **83 biznese debitorë në vlerën 7,317,000 lekë** (si e ardhur e munguar), bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, (pavarësisht kërkesave të mëparshme duke i rikërkuar vazhdimisht) **dhe ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a. Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b. Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

c. Zyra e taksave për mos pagesën e taksave në afat të aplikojë dënim me gjobë për pagesat e vonuara, në masën 0,06% kamat vonesë për çdo ditë vonesë por jo më tepër se 365 ditë, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

d. Nga ana e Zyrës së taksave Bashkia Libohovë të listohen në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës **nga 1158 fermerë** për vlerën **8,268,000 lekë**, taksa e popullatës për shumën **2.300.000 lekë**, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të MF nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë me Njoftim vlerësimi tatimor **edhe në median lokale** (të Bashkisë Libohovë dhe 2 njësitë Administrative Qendër Libohovë dhe Zagorie), për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimi me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifata etj. Gjendja e debitorëve në shkallë Bashkie Libohovë më datën 31.12.2015 në mënyrë të cilat duhen të paguhet në përmbledhur paraqitet më poshtë:

Nr	Emërtimi	Sipas bilancit kontabël më datë 31.12.2015	Sipas listave analitike				Debitor (familjar) tjer,ndert pastr etj	Totali Debitorëve në 000 /Leke
			Biznese private		Debitorët e Tokës			
			Numri	000/lek	Numri	000/lek	000/lek	
1	Bashkia Libohovë	Nuk jane regj në kontab	58	6.400	557	4.900	1.100	12,400
2	Njesia Adm. Qendër	Nuk jane regj në kontab	21	500	422	2.800	1.000	4,300
3	Njesia Adm. Zagorie	Nuk jane regj në kontab	4	417	136	568	200	985
	SHUMA		83	7.317	1.158	8.268	2.300	17,685

14. BASHKIA PËRMET

Nga KLSH me shkresën nr. 997/9 datë 29.02.2016 i janë rekomanduar Bashkisë Përmet, rekomandime për të arkëtimin e vlerës **së dëmit për 11,026,618 lekë**, ku nga verifikimi rezulton se janë në proces zbatimi 5 rekomandime, është zbatuar 1 rekomandim dhe nuk janë pranuar 3 rekomandime, në vlerën **7,725,883 lekë**, për të cilat rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:

1/1.1Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masat duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **prej 7,056,994 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e

nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit në ngarkim të V.P. J.P. dhe D.D. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

2/2.1.Rekomandim: Bashkia Përmet dhe IMT të marrin masa për arkëtimin e shumës prej **400,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi Procedurës Civile” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit” i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre, për rastet:

Nr.	SUBJEKTI	KOSTATIMI	PEZULLIMI	PRISHJE	EKZEKUTIM
1.	sh.p.k	Nr. 72, 12.07.13	Nr. 37, 12.07.13	Nr. 7,31.10.13	-
2.	L.G.	Nr. 85, 04.06.14	Nr. 40, 04.06.14	-	-
3.	A.B.	Nr. 89, 28.07.15	Nr. 41, 28.07.15	-	-
4.	sh.p.k	Nr. 90, 08.10.15	Nr. 20, 08.10.15	-	-

3/3.1.Rekomandim: Bashkia Përmet dhe IMT të marrin masa për arkëtimin e shumës **600,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi Procedurës Civile” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit” i ndryshuar, për rastet:

Nr.	SUBJEKTI	KOSTATIMI	PEZULLIMI	PRISHJE	EKZEKUTIM
1.	sh.p.k	Nr. 72, 12.07.13	Nr. 37, 12.07.13	Nr. 7, 31.10.13	-
2.	Y.B.	Nr. 73, 25.07.13	Nr. 38, 25.07.13	Nr. 8, 12.11.13	04.12.2013
3.	I.M.	Nr. 77, 03.03.14	-	Nr. 13, 15.08.14	26.08.2014
4.	Gj.M.	Nr. 79, 04.03.14	-	Nr. 15, 30.01.15	05.10.2015
5.	Dh.N.	Nr. 86, 11.08.14	-	Nr. 13, 15.08.14	26.08.2014
6.	D.T.	Nr. 88, 26.01.15	-	Nr. 15, 30.01.15	05.10.2015

4/4.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **198,623 lekë**, ndaj z. A.P. në cilësinë e Projektuesit dhe z. G.J. në cilësinë e ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

5/5.1.Rekomandim: Bashkia Përmet, të marr masa për arkëtimin e detyrimit ekonomik 63,000 lekë për periudhën qershor-dhjetor 2015 për subjektin në zbatim të Kreut III të VKM nr. 54, datë 05.02.2014.

6/6.1.Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **542,800 lekë** përkatësisht nga B.H. në shumën 144,400 lekë, nga L.M. në shumën 51,990 lekë, nga K.S. në shumën 199,200 lekë dhe E.K. në shumën 199,200 lekë.

7/7.1.Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **1,190,500 lekë nga firma**, përfituar padrejtësisht nga përlllogaritja dy herë e TVSH mbi zërat e situacionuar për makineri e paisje, të cilat duhet të zbriteshin nga shuma e shpenzimeve të situacionit para se të aplikohet TVSH.

8/8.1.Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës 240,000 lekë në mënyrë solidare nga hartuesi dhe miratuesi i projektit përkatësisht nga z. G.J. në shumën **120,000 lekë** dhe z.B.P. në shumën **120,000 lekë**, për pagesë të kryer në mungesë të dokumentacionit të plotë financiar.

9/9.1.Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **270,266 lekë** nga firma për mungesë dokumentacioni që vërtetojnë se punimet janë kryer.

15. BASHKIA BERAT

Nga KLSH me shkresën nr. 1104/9, datë 14.05.2016 i janë rekomanduar Bashkisë Berat për shpërblimin e dëmit në vlerën **55,828,297**. Nga verifikimi rezulton se janë pranuar të **27** masat e rekomanduara, prej tyre janë zbatuar plotësisht 3 masa me vlerë 464,470 lekë, janë zbatuar pjesërisht 7 masa në vlerë 20,889,364 lekë, janë në proces zbatimi 16 masa në vlerë 34,457,963 lekë dhe është e pa zbatuara 1 masë me vlerën 16,500 lekë, për të cilat **rikërkojmë** zbatimin e tyre si më poshtë:

1/2.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e vlerës **2,500,317 lekë**, paguar **48** anëtarë të këshillit të Bashkisë për ditët që nuk kanë marrë pjesë në mbledhjen, sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2/8.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e shumës **10,000 lekë**, të ndarë si më poshtë:

- vlera **3,333 lekë nga N.K.** në cilësinë e anëtares së Komisionit Blerjeve Vogla.

- vlera **3,333 lekë nga A.C.** në cilësinë e anëtares së Komisionit Blerjeve Vogla.

- vlera **3,333 lekë nga F.K.** në cilësinë e anëtares së Komisionit Blerjeve Vogla.

3/10.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e vlerës **20,980 lekë**, nga Ll.H. Kryetar, O.H. dhe N.K. si anëtar të komisioni i vlerësimit të vlerës fillestare të automjetit që është shitur si skrap.

4/11.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën **3,842,212 lekë**, të ndarë si më poshtë:

- vlera **1,280,738 lekë**, nga E.P. me detyrë kryetare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vlerësim të gabuar të ofertës ekonomike për shpallje fitues të OE [REDACTED].

- vlera **1,280,738 lekë**, nga F.K. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vlerësim të gabuar të ofertës ekonomike për shpallje fitues të OE [REDACTED].

- vlera **1,280,738 lekë**, nga M.S. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vlerësim të gabuar të ofertës ekonomike për shpallje fitues të OE [REDACTED].

5/12.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën **964,515 lekë**, të ndarë si më poshtë:

- vlera **321,505 lekë**, nga E.P. me detyrë kryetare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke s`kualifikuar OE me vlerë më të vogël [REDACTED].

- vlera **321,505 lekë**, nga F.K. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke s`kualifikuar OE me vlerë më të vogël [REDACTED].

- vlera **321,505 lekë**, nga M.S. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke s`kualifikuar OE me vlerë më të vogël [REDACTED].

6/13.1 Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duken ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën 19,180 lekë, të ndarë si më poshtë:

- vlera **6,394 lekë**, nga E.P. me detyrë kryetare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke s`kualifikuar OE me vlerë më të vogël [REDACTED].

- vlera **6,394 lekë**, nga F.K. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke s`kualifikuar OE me vlerë më të vogël [REDACTED].

- vlera **6,394 lekë**, nga M.S. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke s`kualifikuar OE me vlerë më të vogël [REDACTED].

7/14.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **111,800 lekë**, nga kompania e sigurimeve [REDACTED] me numër serie 0046675 dhe nga OE [REDACTED], për mos konfiskim të sigurimit të ofertës.

8/15.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën **190,550 lekë**, të ndarë si më poshtë:

- vlera **63,517 lekë**, nga K.Gj. me detyrë anëtar të Njësisë së Prokurimit, duke bërë copëzimin e fondeve për blerje ushqimesh.
- vlera **63,517 lekë**, nga M.K. me detyrë anëtar të Njësisë së Prokurimit, duke bërë copëzimin e fondeve për blerje ushqimesh.
- vlera **63,517 lekë**, nga H.D. me detyrë anëtar të Njësisë së Prokurimit, duke bërë copëzimin e fondeve për blerje ushqimesh.

9/9/16.1 Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën **169,113 lekë**, të ndarë si më poshtë:

- vlera **56,371 lekë**, nga R.K. me detyrë anëtar të Njësisë së Prokurimit, duke bërë copëzimin e fondeve për blerje ushqimesh.
- vlera **56,371 lekë**, nga M.K. me detyrë anëtar të Njësisë së Prokurimit, duke bërë copëzimin e fondeve për blerje ushqimesh.
- vlera **56,371 lekë**, nga H.D. me detyrë anëtar të Njësisë së Prokurimit, duke bërë copëzimin e fondeve për blerje ushqimesh.

10/14.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **5,992,146 lekë**, nga bashkimi i operatorëve ekonomik [REDACTED] paguar për volume të pakryera në objektin “Rikonstruksion i Shëtitores “Osumi” Berat (Aksi kryesorë L = 831 ml, aksi 1 L = 82.4 ml”.

11/18.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **434,250 lekë**, nga bashkimi i operatorëve ekonomik [REDACTED], për punime të pa kryera në objektin “Rivitalizim i Parkut Perëndimorë të Qendrës dhe nënkalimi i Unazës Perimetrale”.

12/19.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **5,808,150 lekë**, nga operatori ekonomik [REDACTED], për punime të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i trotuareve, parmacëve dhe ndriçimit në segmenti Ura e Varur-Ura e Gorricës”.

13/20.1. Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën **1,887,884 lekë**, të ndarë si më poshtë:

10/1.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin të shumës **4,458,388 lekë** të përfituar padrejtësisht nga Këshilltarët për punë të pakryer, ku nga këto: këshilltarët e Bashkisë Përrenjas në shumën 1,351,070 lekë, këshilltarët e ish-Komunës Qukës në shumën 1,369,497 lekë, këshilltarët e ish-Komunës Rrajcë në shumën 918,608 lekë, këshilltarët e ish-Komunës Stravaj në shumën 819,213 lekë sipas shumave përkatëse të përlllogaritura për çdo këshilltar sipas pjesëmarrjeve në mbledhje në çdo muaj të paraqitur në aneksin nr. 6 të Raportit Përfundimtar.

11/1.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas të marrë masat për kontabilizimin e detyrimit dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin të shumës **2,521,000 lekë** të përfituar padrejtësisht nga punonjësit dhe titullarët nga pagesa për udhëtime e dieta për shërbime fiktive

jashtë qendrës së punës, ku nga këto: administrata e Bashkisë Përrenjas në shumën 817,500 lekë, administrata e ish-Komunës Qukës në shumën 1,199,000 lekë, administrata e ish-Komunës Rrajcë në shumën 317,000 lekë, administrata e ish-Komunës Stravaj në shumën 187,500 lekë sipas shumave përkatëse të përlllogaritura për çdo punonjës të paguar të paraqitur në tabelën në aneksin nr. 1, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

12/1.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin të shumës prej **365,670 lekë** të përfituar padrejtësisht nga shpërblymi i menjëhershëm me 2 paga për largim nga funksioni për tre ish-Kryetarët e Komunave e ndarë përkatësisht: vlera prej 135,150 lekë nga z. F.K. ish-Kryetar i ish-Komunës Qukës, vlera prej 135,150 lekë nga H.Ç. ish-Kryetar i ish-Komunës Rrajcë dhe vlera prej 95,370 lekë nga A.Z. ish-Kryetar i ish-Komunës Stravaj.

13/1.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin të shumës prej **496,748 lekë**, nga z. E.A. Qukës, detyrim i pa llogaritur dhe i pa arkëtuar, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për lejen e ndërtimit nr. 363, datë 30.06.2015 sipas Vendimit të ish-Kryetarit Komunës, Qukës me nr. 01, datë 30.06.2015 me objekt “Linjë përpunimi qumështi”.

14/1.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin të shumës prej **2,203,961 lekë**, nga KVO, ish-Komuna Qukës, i përbërë nga E.V. Kryetar, S.A. anëtar dhe E.K. anëtar pasi në procedurën e prokurimit të fondeve me objekt “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” Pishkash, Komuna Qukës”, ka marrë vendim për s’kualifikimin në mënyrë të kundra ligjshme të ofertës me vlerë më të ulët në shumën 2,203,961 lekë nga oferta e shpallur fituese në mënyrë të kundra ligjshme.

B 2. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1.1. Rekomandimi: Bashkia Përrenjas në bashkëpunim Njësitë Administrative Qukës, Rrajcë dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke lidhur kontrata qiraje, para noterit publik, në përputhje me nenin 39 germa f, nenet 40, 54, 56, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe pikat 3, 4, 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, të ndryshuar, duke përcaktuar dhe arkëtuar detyrimet për qiranë në vlerën **383,746,864 lekë**, respektivisht:

-Subjekti [REDAKTUAR] për sipërfaqen 25.4 ha me vlerë **13,581,334 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] për sipërfaqen 51.95 ha me vlerë **45,716,000 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] për sipërfaqen 166 ha me vlerë **146,080,000 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] për sipërfaqen 3.2 ha me vlerën **2,816,000 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] për sipërfaqen 30 ha me vlerën **26,400,000 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] për sipërfaqen 130.4 ha me vlerën **114,752,000 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] për sipërfaqen 3.3 ha me vlerën **2,299,000 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] shpk për sipërfaqen 2.6 ha me vlerën **1,144,000 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] për sipërfaqen 23 ha me vlerën **20,240,000 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] për sipërfaqen 12.4 ha me vlerën **9,093,330 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] për sipërfaqen 1.54 ha me vlerën **1,355,200 lekë**.

22. BASHKIA SHIJAK:

Nga verifikimi rezulton se janë pranuar të **25** masat e rekomanduara nga KLSH me shkresën nr 243/8, datë 30.06.2016 për vlerën **27,311,729 lekë**. Prej tyre janë zbatuar plotësisht 4 rekomandime në vlerën 46,973 lekë, zbatuar pjesërisht 2 rekomandim në vlerën 314,336 lekë dhe

pa zbatuar apo janë në proces zbatimi 19 rekomandime në vlerën 26,950,420 lekë, për të cilat rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:

1/1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat për arkëtimin e qiramarrësit S.B. në vlerën **24,521,525 lekë**, që përbën vlerën e qirasë së truallit për 7 vite.

2/1.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **932,001 lekë** nga 14 këshilltarë të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

3/1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **594,987 lekë**.

4/1.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **477,120 lekë**.

5/1.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **129,800 lekë**.

6/1.1. Rekomandim: Bashkia Shijak të kërkojë në rrugë ligjore nga L.S. arkëtimin e shumës **16,570 lekë** dhe nga D.S. arkëtimin e shumës **31,570 lekë**.

7/1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **69,350 lekë**.

8/1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **63,204 lekë**.

9/1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **30,401 lekë**.

10/1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **13,720 lekë**.

11/1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **10,800 lekë**.

12/1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **9,732 lekë**.

13/1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **9,568 lekë**.

14/1.1. Rekomandimi Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **6,480 lekë**.

15/1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **4,968 lekë**.

16/1.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **3,630 lekë**.

17/1.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **3,450 lekë**.

18/1.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa, për arkëtimin e detyrimit nga subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **3,191 lekë**.

23. BASHKIA KORÇË

Nga KLSH me shkresën nr. 768//9 datë 06.01.2016 i janë rekomanduar Bashkisë Korçë për shpërblimi **vlera 3,950,000 lekë**, prej tyre edhe pse është pranuar vlera e 3,800,000 lekë, e cila përfaqëson rekomandimin për vendosjen e gjobave për ndërtimet e kundërligjshme, por nuk është zbatuar me arsyetimin se kanë kaluar mbi 30 ditë teje afateve të nxjerrjes së vendimeve gjyqësore, të përcaktuar në nenin 46 të ligjit 10 433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Ndërsa edhe pse është pranuar 1 masa shpërblim dëmi në vlerën 150,000 lekë, ende nuk ishin zbatuar, për të cilat rikërkojmë zbatimin e **saj si më poshtë:**

1/1.1 Rekomandimi: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën totale **150,169 lekë**. Konkretisht, I.L. i komanduar me detyrën e Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor, për vlerën 26,453 lekë dhe K.K. me detyrë Drejtor i Departamentit i të Ardhurave Vendore, për vlerën 123,716 lekë.

24. BASHKIA BELSH

KLSH me shkresën nr. 1103/7, datë 05.04.2016 ka kërkuar realizimin e rekomandimeve për masa për shpërblim dëmi për 18 raste në vlerën **40,791,244 lekë**, nga të cilat, është zbatuar plotësisht 1 rekomandim, në shumën prej 52,522 lekë, janë zbatuar pjesërisht 2 rekomandime dhe janë në proces 15 rekomandime në shumën **prej 40,738,722 lekë**, për të cilat **do rikërkojmë** zbatimin e tyre si më poshtë:

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **5,872,350 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik [REDAKTUAR] në cilësinë e sipërmarrësve të punimeve sipas kontratës nr. - prot., datë 09.08.2013 me objekt: *“Sistëmi i kanalizimeve të ujërave të zeza për fshatin Dëshiran, komuna Grekan”*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore për punime të pakryera.

2.1. Rekomandim: Nga bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,292,825 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik: [REDAKTUAR] në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 410 prot. datë 20.05.2015 me objekt *“Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve të brendshme të bashkisë”* Belsh, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

3.1. Rekomandim: Nga bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,689,231 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik [REDAKTUAR] në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 5 prot., datë 12.11.2012 me objekt *“Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve kryesore të qytetit”*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

4.1. Rekomandim: Nga bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **533,839 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik [REDAKTUAR] në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 1567/12 prot., datë 10.12.2014 me objekt *“Rikonstruksioni i Rrugëve të Bashkisë”*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Belsh, të marrë masa administrative e ligjore dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës së dëmit ndaj personave që i kanë pasur në inventar mjetet e transportit por nuk i kanë dorëzuar në vlerën totale **8,028,679 lekë** si dhe të bëjë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për:

- N.C. për mjetin Fadromin në vlerën.....2,990,000 lekë.
- K.K. për mjetin e transportit me vlerë kontabël4,048,679 lekë.
- Xh.Z. për mjetin veturë tip Benz me vlerë kontabël999,000 lekë.

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia, të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës 162,196 lekë nga ish drejtuesi i mjetit z. Sh.H.

7.1. Rekomandimi: Nga Bashkia, të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës prej 115,275 lekë nga 29 ish kryetarë të fshatrave dhe anëtarë të këshillit të Bashkisë.

8.1. Rekomandimi: Nga Bashkia, të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës prej 396,000 lekë nga personi fizik M.M.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Belsh, të kërkojë arkëtimin e penalitetit të llogaritur ndaj subjektit [REDAKTUAR] në vlerën 3,415,055 lekë.

10.1. Rekomandimi: Bashkia Belsh, të kontabilizojë shumën e detyrimit **5,242,519 lekë**, në ngarkim të 57 personave fizikë qiramarrës të tokave bujqësore të pandara, për detyrimet e pa likuiduara dhe gjobat (sanksionet) e pa vjela për të 3 vitet 2013, 2014 dhe 2015, shumë e cila është detyrim kontraktor i personave në fjalë dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjithë rrugët administrative dhe gjyqësore, deri në shterimin e plotë të gjithë mundësive. Për personat që nuk paguajnë detyrimet, të bëhet anulimi i kontratës.

11.1. Rekomandimi: Bashkia Belsh, të kontabilizojë shumën e detyrimit **3,569,668 lekë**, në ngarkim të 66 personave fizikë qiramarrës të tokave bujqësore të pandara, për detyrimet e pa likuiduara dhe gjobat (sanksionet) e pa vjela për të 3 vitet 2013, 2014 dhe 2015, shumë e cila është detyrim kontraktor i personave në fjalë dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjithë rrugët administrative dhe gjyqësore, deri në shterimin e plotë të gjithë mundësive.

12.1.Rekomandim: Të merren masat dhe të kërkohe në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **8,266,928 lekë**, nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve, në tenderin me objekt “Sistemim kanalizimeve te ujërave të zeza për fshatin Dëshiran, komuna Grekan” .

13.1.Rekomandim: Të merren masat dhe të kërkohe në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **310,988 lekë**, nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve, në tenderin me objekt “Sistemim kanalizimeve te ujërave të zeza për fshatin Dëshiran, komuna Grekan” .

14.1. Rekomandim: Autoritetit Kontraktor bashkia Belsh të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik në **vlerën 39000 lekë**, nga 3 anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, në mënyrë solidare secili nga **13,000** lekë, respektivisht: nga z. R.Q. z. L.Sh. dhe z. R.D. për arsye se, në cilësinë e anëtarëve të KPVV, kanë s`kualifikuar operatorët ekonomik [REDAKTUAR].

15.1.Rekomandim: Autoritetit Kontraktor bashkia Belsh të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik në **vlerën 220,000 lekë**, nga 3 anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, në mënyrë solidare secili nga **72,000** lekë, respektivisht: z. Sh.I. z. B.I dhe z. L.S. për arsye se, në cilësinë e anëtarëve të KPVV, kanë s`kualifikuar operatorin ekonomik [REDAKTUAR] me vlerë më të ulët se OE i shpallur fitues, kjo në kundërshtim me LPP, RrPP dhe Udhëzimit të APP-së.

16.1.Rekomandim: Autoritetit Kontraktor bashkia Belsh të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik në **vlerën 216,000 lekë**, nga 3 anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të

Vogël, në mënyrë solidare secili nga **72,000** lekë, respektivisht: z. B.P. z.R.H. dhe z. H.M. për arsye se, në cilësinë e anëtarëve të KPVV, kanë s`kualifikuar operatorët ekonomik [REDACTED].

17.1. Rekomandimi: Bashkia Belsh, të kontabilizojë shumën e detyrimit **369,168 lekë**, në ngarkim të 6 personave fizikë të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në asetet pronë e bashkisë dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e dëmit ekonomik nga personat fizikë posedues të pronës bashkiake. Në vazhdim të lidhen me këta persona kontrata vjetore për dhënie me qira të ambienteve publike, ose në të kundërt (në rast refuzimi) të lajmërohen strukturat përkatëse dhe së bashku me Policinë Bashkiake, të ekzekutojnë forcërisht lirin e objekteve.

25. BASHKIA CËRRIK(për ish Komunën Gostimë)

Nga KLSH me shkresën nr. 871/12, datë 17.12.2015 i ka rekomanduar Bashkisë Cërrik, për detyrimet e ish- komunës Gostimë 9 masa për shpërblim dëmi prej **9,803,816 lekë**, të cilat janë pranuar, prej tyre janë në proces zbatimi 8 rekomandime, si dhe është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, për të **cilat rikërkojmë** zbatimin e tyre.

1.3. Rekomandimi: Bashkia Cërrik në të cilën përfshihet njësia administrative Gostimë, të arkëtojë vlerën **522,325 lekë**, si taksa vendore të paarkëtuara në vitin 2013, 2014 dhe 2015 për administratën, shërbimet, këshilltarët dhe kryepjeqhtë e komunës Gostimë (*sipas pasqyrës analitike të pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

26. BASHKIA RROGOZHINË

KLSH me shkresën nr. 1193/11, datë 25.4.2016 i ka rekomanduar Bashkisë Rrogozhinë 8 masa për **shpërblim dëmi** në shumën **prej 5,660,962 lekë**, të cilat janë pranuar, por nuk janë kontabilizua, nga të cilat nuk është zbatuar asnjë rekomandim, **prandaj rikërkojmë zbatimin e plotë të tyre, si më poshtë:**

1.1.Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **1,247,850 lekë** të përfituar padrejtësisht sipas shumave përkatëse nga personat e paguar si sportiste të pa federuar sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.

2.1.Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **60,000 lekë** të përfituar padrejtësisht nga OE [REDACTED] për zërin “mirëmbajtje rrjeti” në shërbimin e internetit. Të shikohet mundësia e rishikimit të kontratës për heqjen e këtij zëri të shtuar tepër, nëse nuk është e mundur, të anulohet kontrata dhe të zhvillohen procedurat e prokurimit për këtë shërbim.

3.1.Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **2,011,000 lekë** të përfituar padrejtësisht nga OE [REDACTED] nga ofertimi dhe situacionimi i vlerës së zërit të shërbimit “Transport mbeturinash me automjet vetëshkarkues nga komuna në vend-depozitim distance 10 km” me çmim më të lartë se çmimi zyrtar i miratuar dhe nga pagesa e vlerës së volumeve dhe sipërfaqeve të rritura në mënyrë të pa argumentuar.

4.1.Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës së penalitetit prej **74,461 lekë** nga Shoqëria [REDACTED] nga mos furnizimi me sasinë e mbetur karburantit të kontraktuar.

5.1.Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës **873,072 lekë** nga z. B.N. në funksionin e Kryetarit të AK dhe në cilësinë e nënpunësit autorizues për blerje të karburantit mbi nevojat, për të cilat nuk ka asnjë dokument mbi përlllogaritjen dhe argumentimin e tyre.

6.1.Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat, që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës **13,288 lekë** prej subjektit [REDAKTUAR] përfituar tepër si rezultat i ndryshimit të çmimit për litër në dy furnizime.

7.1.Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës **37,101 lekë** nga subjekti [REDAKTUAR] përfituar tepër si rezultat i ndryshimit të çmimit për litër të faturuar nga çmimi i bursës.

8.1.Rekomandim: Bashkia Rrogozhinë të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës prej **1 343 790 lekë** përfituar padrejtësisht nga këshilltarët për mos marrje pjesë në mbledhje sipas listës në aneksin nr. 5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

27. KËSHILLI I QARKUT TIRANË

Nga ana e KLSH me shkresën nr. 572/8, datë 9.9.2016 janë dërguar rekomandimet Këshillit të Qarkut Tiranë 6 masa për shpërblim në shumën prej 737,385 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, por që ende nuk ka filluar procesi i zbatimit, prandaj **kërkojmë zbatimin e plotë të tyre**, si më poshtë:

1.1.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **227,341 lekë**, nga punonjësit dhe ish-punonjësit: **znj. M.K.** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në vlerën **61,632 lekë**, **znj. E.D.** me detyrë specialiste finance në Drejtorinë e Koordinim Zhvillimit në vlerën **71,793 lekë**, **znj. E.L.** me detyrë ish-specialiste për politikat sociale në vlerën **45,458 lekë** dhe **znj. E.P.** me detyrë ish-specialiste për arsimin dhe shëndetësinë në vlerën **48,458 lekë**.

2.2.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **41,256 lekë**, nga punonjësja **znj. E D** me detyrë specialiste finance në Drejtorinë e Koordinimit Zhvillim, në cilësinë e ish-Drejtorit Ekonomik për likuidimin e mallit pa dokument.

3.3.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **103,440 lekë**, nga ish-punonjësit: **z. K.T.** me detyrë ish-drejtuës mjeti në vlerën **73,851 lekë**, **z. B.M.** me detyrë punonjës mbështetës i transportit dhe logjistikës në vlerën **29,589 lekë**.

4.4.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të analizoje dhe të kryejë rikontabilizimin e detyrimeve në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm", duke nxjerrë përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës, si dhe të arkëtojë vlerën **166,314 lekë**, respektivisht: subjekti [REDAKTUAR] për vlerën **35,914 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **48,480 lekë** dhe subjekti [REDAKTUAR] për vlerën **81,600 lekë**, si dhe të bëjë korigjimin e rezultatin financiar të vitit 2015, për të njëjtën vlerë.

5.5.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **138,934 lekë**, nga punonjësja **znj. E.D.** me detyrë specialiste finance në Drejtorinë e Koordinimit Zhvillim, në cilësinë e ish-Drejtorit Ekonomik për likuidimin e mallit pa dokument.

6.7.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **60,100 lekë**, ndaj punonjësve

dhe ish-punonjësve: **znj. E.M.** me detyrë ish-specialist finance, në cilësinë e kryetarit të KBVV për vlerën **20,034 lekë**, **znj. G.N.** me detyrë ish-specialist për emergjencat civile, në cilësinë e anëtarit të KBVV për vlerën **20,033 lekë** dhe **znj. E.S.** me detyrë ish-specialiste për bujqësorë, në cilësinë e anëtarit të KBVV për vlerën **20,033 lekë**.

28. KËSHILLI I QARKUT DURRËS

KLSH me shkresën nr. 573/8, datë 23.9.2016 i ka rekomanduar Këshillit të Qarkut Durrës masa për **shpërblim dëmi** në shumën **prej 7,246,842 lekë**, nga të cilat janë pranuar dhe janë në proces zbatimi 2 rekomandime në shumën prej 7,050,642 lekë, por nuk kana filluar ndalesat për shpërblimin e dëmit në vlerën 196,200 lekë, prandaj rikërkojmë zbatimin e **kësaj mase si më poshtë:**

1.3.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Durrës të arkëtojë vlerën prej **196,200 lekë**, për organizimin e një drekë me rastin festave të 28-29 nëntorit për 100 veta me nga 1,962 lekë/secili, shpenzim të kryera pa një mbështetje ligjore.

29. PREFEKTURA E QARKUT TIRANË

Nga KLSH me shkresën nr. 512/6, datë 10.10.2016 i janë rekomanduar Prefekturës Tiranë, 2 masa për **shpërblim dëmi** ndaj ish-Drejtorit **z. Sh.G.** në vlerë **467,000 lekë**, të cilat nuk janë pranuar nga Prefektura Tiranë, me arsyetimin se PMNZSH- Tiranë më datën 01.01.2016 ka kaluar në varësi të Bashkisë Tiranë.

Me këtë argumentim nuk është dakord Kontrolli i Lartë i Shtetit, pasi edhe pse aktiviteti i PMNZSH-Tiranë, ka kaluar në vartësi të Bashkisë Tiranë, dëmi ekonomik nuk i është shkaktuar Bashkisë Tiranë, por Prefekturës Tiranë, e cila duhet të nxjerrë urdhrin ekzekutiv për shpërblimi e dëmit në vartësi të cilës ka qenë kjo strukturë.

Pas nxjerrjes së urdhrin ekzekutiv (urdhër Zhdëmtimit), në se personi nuk paguan në mënyrë vullnetare, atëherë i dërgohet shkresë për kryerjen e ndalesës Bashkisë Tiranë dhe konkretisht detyrimin prej 467,000 lekë, ndaj ish-Drejtorit **z. Sh.G.** Prandaj i rikërkojmë edhe njëherë Prefektit Tiranë, të zbatojnë proceduar ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej **467,000 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2014 dhe 2015 nuk ishin rakorduar të dhënat e pasqyruara në regjistrat mbi numrin e akteve teknike dhe lejeve të ndërtimit, me të dhënat e zyrës së financës ditarit të Bankës (Thesarit). Referuar rakordimit dhe pasqyrave të datës 31.08.2016 të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve të Financës Prefekturës Tiranë dhe specialistes së financës të Drejtorisë shërbimit mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit (MZSH), rezulton se nga ana e Sektorit të PMNZSH-Tiranë nuk ishin pasqyruar në kontabilitet, për pasojë deri më datën 31.08.2016 nuk ishte arkëtuar nga **142 persona** vlera e akteve teknike dhe lejeve të ndërtimit duke shkaktuar në buxhetin e Institucionit Prefektit Qarku Tiranë **një dëm ekonomik në vlerën 377,000 lekë** (*Lista me personat të cilët nuk kanë paguar vlerën e akteve teknike dhe lejeve të ndërtimit është pasqyruar në Aneksin nr. 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1Rekomandimi: Nga ana e Institucionit të Prefektit Qarkut Tiranë, të merren masa për arkëtimin nga z. Sh G, me detyrë shëf sektori i PMNZSH-Tiranë, të vlerës së akteve dhe lejeve të ndërtimit të lëshuara prej tij **në vlerën prej 377,000 lekë dëm ekonomik**, të cilat nuk janë rakorduar, nuk janë pasqyruar në Kontabilitet dhe deri më datën 31.08.2016 rezultojnë të pa arkëtuara në llogarinë e Prefekturës Tiranë.

2. Gjetje nga auditimi: Në **2 raste** në tejkalim kompetence, nga shefi i PMNZSH Tiranë për vitin 2014 janë anuluar **2 gjoba në vlerën 90,000 lekë**, vendosur respektivisht firmes

██████ për vlerën 20,000 lekë, dhe ██████ në vlerën 70.000 lekë, në kundërshtim me neni 39 të ligjit nr. 8766, datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin” i ndryshuar **ku përcaktohet se: Kundër vendimit të oficerit të inspektim-parandalimit të PMNZSH-së, mund të bëhet ankim sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, në organin epror të PMNZSH-së, në ministrinë përgjegjëse. Kundër vendimit të organit epror të PMNZSH-së, mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente, në përputhje me ligjin për inspektimin.**

Rekomandimi: Nga ana e Institucionit të Prefektit Qarkut Tiranë, të merren masa për arkëtimin nga z. **Sh.G.** me detyrë shefi i PMNZSH-Tiranë **vlera prej 90,000 lekë**, e cila përfaqëson anulimin e 2 vendimeve të gjobave për vitin 2014, në tejkalim kompetence, respektivisht ndaj subjektit ██████, më vlerën 20,000 lekë dhe“ subjekti Parkim Nëntokësor” në vlerën 70,000 lekë.

30. KËSHILLI I QARKUT VLORE

KLSH me shkresën nr. 999/10 datë 22.02.2016 i ka rekomanduar Këshillit të Qarkut Vlorë 6 masa, nga verifikim rezultoi se janë zbatuar pjesërisht 5 masa, janë në proces zbatimi 4 masa, 1 masë me vendim të formës së prerë të gjykatës nuk është pranuar duke u dhënë të drejtë përfituesve të shumave dhe nuk kanë filluar procedurat e arkëtimit për **vlerën 3,256,884 lek**, për të cilën **rikërkojmë zbatimin** e tyre si më poshtë:

1.Rekomandim: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar: z. A.Dh. me detyrë ish-Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë, shpërblimin e dëmit në vlerën 315,000 lekë.

2.Rekomandim: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar: z. A.Dh. me detyrë ish-Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë dhe R. Xh. me detyrë ish-shofer i Kryetarit të KQV, shpërblimin e dëmit në vlerën 948,721 lekë.

3.Rekomandim: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar operatori ekonomik ██████, shpërblimin e dëmit në vlerën 772,255 lekë.

5.Rekomandim: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar: znj. V.A. me detyrë zëdhënëse e Këshillit të Qarkut, shpërblimin e dëmit në vlerën 84,770 lekë lekë.

-Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar: z. B.L. me detyrë, Drejtor Kabineti i Këshillit të Qarkut, shpërblimin e dëmit në vlerën 130,415 lekë.

-Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar: znj. J.Xh. me detyrë Drejtore e Financës së Këshillit të Qarkut, shpërblimin e dëmit në vlerën 77,927 lekë.

-Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar: z. K.Gj. me detyrë Këshilltar Ligjor në Këshillin e Qarkut, shpërblimin e dëmit në vlerën 70,745 lekë.

31. BASHKIA TIRANË

a. për Njësinë Administrative Petrelë (ish-Komunën Petrelë): KLSH duke qenë se ish- Komuna Petrele në kuadrin e reformës territoriale është në përbërje të Bashkisë Tiranë, me shkresën nr. 549 datë 07.11.2015 i ka rekomanduar Bashkisë Tiranë masa për shpërblimin e dëmit në vlerën

8,376,660 lekë, masa të cilat deri më datën 09.12.2016 nuk janë marrë në analizë nga Bashkia Tiranë, prandaj **rikërkojmë zbatimin e tyre, si më poshtë:**

1/1Rekomandimi: Bashkia të marrë masa për arkëtimin e vlerës **968,336 lekë**, për pagesa të paligjshme për vitin 2013, 2014 dhe 2015 të 15 këshilltarëve të komunës Petrelë, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këtij këshilli.

2/2Rekomandimi: Bashkia të arkëtojë vlerën **20,000 lekë**, përkatësisht për Y.K. 10,000 lekë dhe M.Sh 10,000 lekë, në lidhje me gjobën e vendosur nga Ministria e Financës, e cila padrejtësisht është paguar nga fondet e komunës.

3/2Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **1,451,833 lekë**, përkatësisht nga KVO H.K. M.K. G.S. dhe njësia e prokurimit F.P. si dhe titullari i AK Y.K. me nga **290,367 lekë/secili**, për diferencë midis firmës fituese dhe asaj me vlerë më të ulët, pasi padrejtësisht fitues është shpallur [REDAKTUAR] me vlerën 22,918,705 lekë, në vend të operatorit ekonomik [REDAKTUAR] për vlerën 21,466,872 lekë më ofertë të leverdishme ekonomike dhe me dokumentacion të rregullt, në tenderin me objekt: *“Ndërtim KUZ Daias Gurrë e Vogël për vitin 2013”*.

4/2Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **105,176 lekë**, për punime të pakryera dhe diferencë çmimi, përfituar nga sipërmarrësi [REDAKTUAR], për objektin *“Ndërtim Kanalizime Ujerave të Zeza Fshati Gurre e Vogël, Gurre e Re dhe Daias”* Komuna Petrelë, sipas kontratës nr. 1127, datë 13.06.2013.

5/5Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **455,196 lekë** nga subjekti [REDAKTUAR], për punime të pakryera në objektin *“Sistemim-Asfaltim Rruga Lagja Mehtan-Shkolla Mullet”* Petrelë, sipas kontratës nr. 2303, datë 28.2.2012.

6/6 Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **671,600 lekë** nga [REDAKTUAR], për punime të pakryera, në objektin *“Ndërtim Ujësjiellësi Fshati Qeha, Komuna Petrele”*, sipas kontratës datë 11.5.2015.

7/7 Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **1,577,138 lekë** nga subjektet [REDAKTUAR] për punime të pakryera, në objektin *“Segmenti rrugor “Fshati i ri – Mullet (vazhdim) Komuna Petrelë”*, sipas kontratës nr. 2244, datë 19.12.2012.

8/8 Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **757,381 lekë nga investori [REDAKTUAR]**, për diferencë të pa paguar për taksën ndikimit të infrastrukturës, për lejen zhvillimore ndërtimi nr. 1554, datë 4.9.2014, për objektin *“Godinë banimi 1 kat dhe 2 kat me bodrume të pjeshme +ambiente rekreative, fshati Fikas”*.

b. Bashkia Tiranë (për Njësitë Administrative Pezë dhe Vaqarr):

KLSH sipas programit të auditimit nr. 240/1, datë 24.02.2016 ka ushtruar auditim tematik në ish-Komunat Pezë dhe Vaqar, me shkresën nr. 703/32 datë 04.04.2016 i ka rekomanduar për

shpërblimin e dëmit, në vlerën totale prej **7,311,360 lekë**, masa të cilat nuk janë marrë në analizë nga Bashkia Tiranë, prandaj **rikërkojmë zbatimin e tyre si më poshtë:**

Gjetjet nga auditimi: Ish-Komuna Vaqarr, lidhur me Kontratën e qirasë nr. 1365, datë 27.08.2014 dhe Kontratës së shitjes nr. 4282 rep. dhe 754 kol. datë 13.07.2015, me shoqërinë [REDAKTUAR] nuk ka pasqyruar faktin se mbi pasurinë objekt transaksioni, subjekti [REDAKTUAR] ka ngritur ndërtim me leje, sipas lejes zhvillimore nr. 01/2, datë 27.02.2015, “Kapanon 1 kat për linjë prodhimi të ushqimit për kafshë”, me sipërfaqe trualli që zhvillohet 20500 m² dhe sipërfaqe e truallit që zë struktura (gjurma) 976 m² dhe kontrata e shitblerjes është lidhur për pasurinë, e llojit tokë pa fryt. Mos ndryshimi i destinacionit të tokës, në truall, ka sjellë për pasojë mos llogaritje çmimi shitje në bazë të VKM nr. 514, datë 30.07.2014, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark”, ku dhe është përcaktuar se çmimi minimal është 395 lekë/m², (976 m² x 395 lekë/m²=385,520 lekë dhe jo 82,960 lekë, ose më shumë 302,560 lekë), shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e NJQV.

Nuk është bërë referimi në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, për sipërfaqen tokë tjetërsuar në truall sipas lejes zhvillimore nr. 01/2, datë 27.02.2015, ku sipas VKM nr. 54, datë 05.02.2014, Kreu III, pika 2 “Kur jepet me qira truall i lirë, tarifa dysheme e qirasë mujore është 100 lekë/m²”. Mos ndryshimi i kushteve të kontratës së qirasë dhe tarifës për pjesën e tokës të tjetërsuar në truall, ka sjellë si rezultat dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën prej 97,600 lekë/muaj (976 m² x 100 lekë/m²), ose për 5 muaj, 488,000 lekë. (Trajtuar në faqet 48-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Njësinë Administrative Ish-Komuna Vaqarr, të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **790,560 lekë** nga të cilat shuma prej 302,560 lekë, shkaktuar nga mos aplikimi i drejtë i çmimit të tokës në kontratën e shitjes nr. 4282 rep. dhe 754 kol. datë 13.07.2015, dhe shumës prej 488,000 lekë, shkaktuar nga mos aplikimi i drejtë i çmimit të tokës në kontratën e qirasë nr. 1365, datë 27.08.2014, për pasurinë e ndodhur në zonën kadastrale 3784, pasuria nr. 1/9 me sipërfaqe prej 20500 m².

2. Gjetjet nga auditimi: Ish-Komuna Vaqarr, lidhur me Kontratën e qirasë nr. s’ka, datë 28.01.2013, me shoqërinë [REDAKTUAR] nuk ka pasqyruar faktin se mbi pasurinë objekt transaksioni, subjekti [REDAKTUAR] ka ngritur ndërtim me leje, sipas lejes zhvillimore nr. 08/8, datë 16.10.2013, “Kapanon metalik 1 kat me elementë të çmontueshëm”, me sipërfaqe trualli që zhvillohet 46225 m² dhe sipërfaqe e truallit që zë struktura (gjurma) 2508 m².

Mos ndryshimi i destinacionit të tokës, në truall, ka sjellë për pasojë mos referim në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, për sipërfaqen tokë tjetërsuar në truall sipas lejes zhvillimore nr. 08/8, datë 16.10.2013, ku sipas VKM nr. 54, datë 05.02.2014, Kreu III, pika 2 “Kur jepet me qira truall i lirë, tarifa dysheme e qirasë mujore është 100 lekë/m²”. Mos ndryshimi i kushteve të kontratës së qirasë dhe tarifës për pjesën e tokës të tjetërsuar në truall, ka sjellë si rezultat dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën prej 250,800 lekë/muaj (2508 m² x 100 lekë/m²), për 26 muaj, 6,520,800 lekë. (Trajtuar në faqet 30-36 dhe 53-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Njësinë Administrative Ish-Komuna Vaqarr, të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **6,520,800 lekë**, shkaktuar nga mos aplikimi i drejtë i çmimit të tokës në kontratën e qirasë nr. ka, datë 28.01.2013, për pasurinë e ndodhur në zk. 3712, pasuria nr. 172/3 me sipërfaqe prej 9375 m² dhe pasuria nr. 180/1 me sipërfaqe prej 36850 m².

32. BASHKIA KONISPOL (për ish komunën Markat)

Me shkresën nr. 128/19, 01.06.2016 KLSH ka rekomanduara 19 masa me vlerë **92,464,818 lekë**, nga të cilat 42,825,135 lekë dëm ekonomik dhe 49,639,683 lekë, dëme të likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve, janë pranuar plotësisht 17 masa janë në proces zbatimi me vlerë 86,040 mijë lekë, (proces administrative e gjyqësore etj) dhe nuk janë pranuar 2 masa në vlerën **9,424 mijë lekë**, për të cilat **rikërkojmë zbatimin e masave** të pa realizuara si më poshtë:

1.Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **73,971 lekë**, nga zj. M.A. *ish-Kryetare e Bashkisë*, për tejkallim normative të shpenzimeve celulare, për vitin 2013, 2014 dhe 2015.

2.3 Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **38,000 lekë**, nga përgjegjësja e shërbimeve **T.Ç. shpenzimi i pajustificuar**, sipas urdhër shpenzimit nr. 196, datë 15.9.2014, për gjërmim e transport dheu 60 m3 rruga Postbllok-Konispol, pasi nuk ka projekt, nuk ka fotografime para punimeve dhe pas punimeve, nuk ka përmasime të kanalit për efekt të justifikimit të 60 m3 dhe nuk ka kërkesë të sektorit shërbimeve dhe miratim të saj.

3.4 Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **106,250 lekë**, nga M.A. për mungesë inventari 1 Laptop HP pasi nuk është dorëzuar nga ish-kryetarja e bashkisë, sipas fletëdaljes nr. 2, datë 24.2.206, procesverbalit datë 3.8.2015 dhe shkresës nr. 560 datë 02.09.2015 të bashkisë.

4.5 Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **189,360 lekë**, nga shoferi **D.Z. 94,680 lekë** dhe punonjësja e shërbimeve **T.C. 94,680 lekë**, për **tejkallim normativave të karburantit** të mjetit tip “Benz” në përdorim të administratës me targa SR7319B, sipas rekordimit të fletudhëtimeve me sasinë e furnizuar dhe me normativat e miratuara, për vitin 2013 dhe për vitin 2014.

5.Rekomandimi: Nga Bashkia Konispol të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **7,918,215 lekë** pa t.v.sh, nga të cilat:

- **Vlera 1,341,882 lekë** pa t.v.sh për punime të pakryera në fakt;

- **Vlera 6,603,333 lekë** dëme të likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve;

nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 514, datë 30.06.2014 me objekt: “**Rikonstrukcion Qendra e Qytetit Konispol**”, Bashkia Konispol, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera dhe dëme për vonesa në zbatim të kontratës .

6.Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **60,000 lekë** nga M.A. dhe S.B. me nga **30,000 lekë secili**.

7.Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa për arkëtimin e shumën **72,708 lekë** nga F.B. për pagë të dubluar.

Bashkia Konispol (Për ish-komunën Markat) dëmi ekonomik në vlerën 74,136,802 lekë.

8.Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **7,432,624 lekë**, që përbëhet nga vlerësimi i gabuar i ofertës ekonomike të shpallur fitues në tenderin me objekt: “**Rruga Janjar-Ninat- Markat**”, nga KVO, përkatësisht **A.S. 1,858,156 lekë, E.R. 1,858,156 lekë, E.M. 1,858,156 lekë dhe ish Titullari i Autoritetit Kontraktor I.M. 1,858,156 lekë**.

9. Rekomandimi: Nga Bashkia Konispol të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **58,355,550 lekë** pa t.v.sh nga **subjekti** [REDAKTUAR], nga të ciat:

- **vlera 15,319,200 lekë** pa t.v.sh për punime të pakryera në fakt;

-**vlera 43,036,350 lekë** dëme të likuidueshme për vonesën në mbarimin jo të plotë të punimeve;

Nga operatori ekonomik [REDAKTUAR], në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 71 prot., datë 12.09.2012 me objekt: “**Rruga Janjar-Ninat-Markat**”, ish Komuna Markat, Konispol, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë

vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera dhe dëme për vonesa në zbatim të kontratës.

10.Rekomandimi: Bashkia Konispol (Njësia Administrative Markat) të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **181,500 lekë** për **pagesa të paligjshme të 22 këshilltarëve** të ish-komunës Markat, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këtij këshilli, për vitin 2013, 2014 dhe 2015.

11.13.Rekomandimi: Bashkia Konispol (Njësia Administrative Markat) të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **145,735 lekë**, pasi janë paguar në kundërshtim me VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 586 datë 17.07.2013, përkatësisht: ish-kryetari i Komunës **I.M. 103,150 lekë**, ish-përgjegjësi financës **I.B. 11,265 lekë** dhe ish-punonjës i komunës **I.S. 31,320 lekë**.

12.14 Rekomandimi: Bashkia Konispol (Njësia Administrative Markat) të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **195,500 lekë**, paga të patërhequra dhe të paarkëtuara të punonjësve me kontratë, këshilltarëve dhe kryetarëve përkatësisht: M.M. 13,500 lekë, O.H. 13,500 lekë, N.D. 13,500 lekë, K.M.13,500 lekë, A.M. 13,500 lekë, L.D. 24,000 lekë, A.S. 24,000 lekë, D.H. 24,000 lekë, R.R. 24,000 lekë, S.D. 16,000 lekë, F.E. 16,000 lekë.

13/15. Rekomandimi: Bashkia Konispol (Njësia Administrative Markat) të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **550,661 lekë (330,661+220,000)**, përkatësisht ish-Kryetari i Komunës **I.M. 275,330 lekë dhe I.B. 275,330 lekë**, shpenzime të pa justifikuar me dokumente në 2 raste, pasi mungon fatura, preventivi, situacioni, vendimi i Këshillit Komunës, procesverbali i komisionit shërbimeve të vogla, fotografimet para dhe pas meremetimit të objektit, akt marrja në dorëzim etj, sipas urdhër shpenzimeve nr. 16, datë 9.02.2015, nr. 17 datë 10.02.2015, nr. 41, datë 10.04.2015, faturës nr. 1, 2,3 datë 6.2.2015.

14/16 Rekomandimi: Bashkia Konispol (Njësia Administrative Markat) të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **102,000 lekë** përfitim **dieta të tepërta** për vitin 2013, 2014, 6-mujori 2015, pasi janë kryer pagesat për shpenzimet e hotelit pa faturën tatimore dhe pa kuponët tatimor elektronik, konkretisht:

-vlera 69,000 lekë, nga **I.M.** sipas urdhër shpenzimit nr. 4, datë 17.11.2014 për datat 3, 4, 5, 25, 26, 27 nëntor 2014 dhe 3, 4, 22, 23 dhjetor 2014, sipas urdhër shpenzimit nr. 31, datë 9.3.2015 (*dieta janar-shkurt*) për datat 12,13, 14, 21, 22, 27,28,29 janar 2015 dhe 4, 5 , 17, 18, 19 shkurt 2015.

-vlera 24,000 lekë, nga **I.B.** sipas urdhër shpenzimit nr. 4, datë 17.11.2014 për datat 10 e 11 dhjetor 2014, sipas urdhër shpenzimit nr. 31, datë 9.3.2015 (*dieta janar-shkurt*) për datat 19,20, 21, 23, 24, 25 janar 2015.

-vlera 9,000 lekë, nga **A.I.** sipas urdhër shpenzimit nr. 31, datë 9.3.2015 (*dieta janar-shkurt*) për datat 27, 28, 29 janar 2015.

15/1.Rekomandimi: Rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të mëparshme nga Bashkia Konispol, duke kontabilizuar dhe arkëtuar vlerën **774,498 lekë**, përkatësisht: subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **289,150 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **337,600 lekë**, subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **97,288 lekë** dhe subjekti [REDAKTUAR] në vlerën **50,000 lekë**, sipas shkresës të KLSH nr. 380/6, datë 6.2.2012, për ish-Komunën Markat.

16/18 Rekomandimi: Rikërkojmë Bashkisë Konispol, zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të Auditit të Prefekturës Vlorë, për ish-Komunën Markat, kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës **796,538 lekë** për subjektin [REDAKTUAR] për **punë të pakryer** në 2 objekte kontraktore të komunës Markat, përkatësisht **21,710 lekë** për objektin “*Ambulancë fshati Janjar*” dhe **774,828 lekë** për objektin “*shkolla 9-vjeçare fshati Janjar*”.

7/19.Rekomandimi: Bashkia Konispol (Njësia Administrative Markat) të marrë masa për arkëtimin e shumën **5,302,780** lekë nga **I.M.** ish-Kryetar i Komunës Markat **2,651,390 lekë** dhe **Ibrahim Bastri** ish-përgjegjës i financës **2,651,390 lekë** për kryerjen e shpenzimeve të paligjshme dhe pa dokumentacion justifikues.

33. BASHKIA VLORË:

Me shkresat nr. 707/14, datë 30.06.2014, nr. 1128/58, datë 19.03.2015 dhe nr. 1015/14, datë 30.08.2016 KLSH ka rekomanduar 1 masë në vlerën **44,499,901 lekë**, nga verifikim rezulton se çështja është në proces Gjyqësor, bazuar në vërtetimin e Gjykatës administrative të Shkallës parë Vlorë datë 13.01.2017, ku vërteton se çështja civile nr 31003029-2016 datë 1.12.2016, kundërshtim shpërblim dëmi nr. 9313 prot, datë 04.12.2016, prandaj kjo masë nuk do rikërkohet, por to të ndjekim ecurinë e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit.

C.MASAT DISIPLINORE

Në 43 subjektet e verifikuara për zbatim rekomandimesh 28 subjekte janë audituar përgjatë periudhës 9/mujorit 2016 ndërsa 10 subjekte për periudhën e tremujorit IV-të 2015 të cilat u përkasin 2 Bashkive dhe 8 ish-komunave të cilat janë suprimuar dhe bashkë me to edhe masat konsiderohen të zbatuara.

a.Mbi masat disiplinore për 28 subjektet e audituara përgjatë periudhës 9/mujorit 2016.

Nga **275 masa** disiplinore të rekomanduara, janë zbatuar 147 masa ose në masën 52 %, duke mos u zbatuar 128 masa, nga të cilat 23 masa u përkasin 3-ish Komunave, aktualisht të suprimuara dhe 9 masa Bashkisë Korçë ku kjo e fundit i ka pranuar, duke i konsideruar edhe 44 masa të zbatuara, zbatimi shkon në **191 masa disiplinore (147+44) ose me një zbatueshmëri në masën 70%**

Nuk kanë zbatuar masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH respektivisht Bashkitë: Konispol 15 masa, Tiranë 13 masa, Rrogozhinë 11 masa, Përrenjas 9 masa, Lezhë Bulqizë dhe Poliçan nga 7 masa, Prefektura Tiranë 6 masa, etj.

b.Në 10 Subjektet e audituara në tremujorin e IV-të të vitit 2015

Në 10 **Subjektet e audituara për në tremujorin e IV-të të vitit 2015**, nga 111 masa disiplinore të rekomanduara, janë pranuar 101 masa prej tyre janë zbatuar 47 masa disiplinore ose në masën 42 %, duke mos u zbatuar 59 masa, nga të cilat 34 masa u përkasin 5-ish Komunave, 16 masa Bashkisë Gjirokastrë dhe 9 masa Bashkisë Korçë ku kjo e fundit i ka pranuar, duke i konsideruar edhe 43 masa të realizuara, (34+9) , realizimi shkon në 90 masa (47+43) ose në masën 81 % .

Nuk kanë zbatuar masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH respektivisht, Bashkitë: Gjirokastrë 18 masa, Bashkia Korçë 9 masa disiplinore (sqarojmë se nga kryetari i Bashkisë Korçë për këto masa i janë dërguar për vendimmarrje Komisionit Disiplinor, por ky i fundit pas shqyrtimit të shkeljeve disiplinore ka vendosur "Ndërprerjen e ecurisë Disiplinore", këto masa mund të konsiderohen edhe të realizuara, pasi Komisioni i ka marrë në shqyrtim, pra i ka pranuar)

Dhe 5 ish- komuna të cilat janë suprimuar dhe masat konsiderohen të realizuara respektivisht: ish Komuna Petrelë 18 masa disiplinore (aktualisht Njësi Administrative në përbërje të Bashkisë Tiranë) ish-Komuna Balldre Lezhë, 2 masa disiplinore (aktualisht Njësi administrative në përbërje të Bashkisë Lezhë), ish-Komuna Gostimë Cërrrik 3 masa disiplinore, (aktualisht Njësi administrative e Bashkisë Cërrrik).

Bazuar në nenin 15 shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 datë 18.12.2014; Kreu I- Organet Disiplinore, pikat 3 dhe 10, të VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, dhe nenin 64, shkronja (g) të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD) , të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil dhe për punonjësit të cilët marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, bazuar në nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës në R.SH”, i ndryshuar, marrjen e masës disiplinore”, në 20 subjektet dhe personat **si më poshtë:**

1. BASHKIA FUSHË ARRËZ

Nga KLSH-ja janë rekomanduar 7 masa disiplinore, për 4 punonjës marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen sipas ligjit shërbimit civil dhe 3 punonjës me Kod Punë. Nuk janë pranuar dhe nuk janë dhënë masa disiplinore për asnjë nga punonjësit e rekomanduar për dhënien e masave disiplinore, prandaj **i rikërkojmë** Kryetarit të Bashkisë që t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 7 punonjës, respektivisht:

a. Për 4 punonjësit të cilët janë pjesë e shërbimit civil

“Mbajtja deri në 1/3 e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për 4 punonjësit si më poshtë:

- 1. Zj. P.P. me detyrë Juriste Bashkia Fushë Arrëz dhe në pozicionin e ish-Kryetarit të Komisionit të Blerjeve me Vlera të Vogla (KBVV),**
- 2. Z. I.A. me detyrë specialist finance** Njësia Administrative Fierzë, në pozicionin ish-P/Zyrës së Financës dhe ish-anëtar i KBVV në Komunën Fierzë
- 3. Z. F.D. me detyrë specialist finance** Njësia Administrative Blerim, në pozicionin e ish-P/Zyrës së Financës Komuna Blerim dhe si anëtar i KBVV
- 4. Zj. E.E. me detyrë Përgjegjëse në Zyrën e Financës Bashkia Fushë Arrëz, në cilësinë e anëtarit të KBVV, Komuna Qafë Mali,**

b. Për 3 punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe pikës 8 të kontratës individuale të punës, **i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë** që të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për 3 punonjësit si më poshtë:

“Vërejtje me paralajmërim”, pika 8/2 e kontratës individuale.

- 1. Z. K.V. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të KBVV.**
- 2. Znj. F.K. me detyrë magazinierë në Bashkinë Fushë Arrëz,**
- 3. Z. B.J. me detyrë Inspektor i Taksave Vendore Njësia Administrative Fierzë, në pozicionin e ish-magazinierit të Komunës Fierzë.**

2. BASHKIA BULOQIZË.

Nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Bulqizë marrja e masës disiplinore “Vërejtje” deri në “Zgjdhjen e menjëhershme të kontratës së punës”, për 7 punonjës dhe nga verifikimi rezultoi se nuk janë marrë në konsideratë rekomandimet e KLSH për marrje masë disiplinore.

Prandaj, mbështetur i rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë që të klasifikojë shkeljet disiplinore dhe **ti rekomandojë** Komisionit Disiplinor të fillojë procedurat për ecurinë disiplinore, për

punonjësit që marrëdhëniet e punë rregullohen me Statusin e Nëpunësit Civil **masë disiplinore “Vërejtje” deri “Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”,** “dhe për punonjësit që trajtohen me Kodin e Punës nga masë disiplinore “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e kontratës së punës”, për **7 punonjësit si më poshtë:**

1.Zj. Sh.O. me detyrë specialiste e financës në Bashkinë Bulqizë,

2.Z.R.B. me detyrë Drejtor i Financës, Bashkia Bulqizë nga data 02.10.2015 e në vazhdim.

3.Z.F.Z. me detyrë ish Kryetar i Komunës Fushë-Bulqizë, aktualisht Administrator në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë.

4.Z.V.B. me detyrë specialiste e Zyrës së Urbanistikës, në cilësinë e ish Përgjegjëse e Sektorit të Taksave për periudhën 26.07.2013- 13.08.2014.

5.Zj. A.H. me detyrë Specialiste e Menaxhimit të Pronave dhe në cilësinë e ish Përgjegjëse e Sektorit të Pronave për periudhën 16.06.2011 deri më 18.01.2015;

6.Z. L.D. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave nga data 18.01.2015 e në vazhdim

7.Z. F.B. me detyrë ish Kryetar i Komunës Trebisht, aktualisht Administrator në Njësinë Administrative Trebisht.

3.BASHKIA MIRDITË

a.Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës

Nga KLSH, i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Mirditë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masës **“Zgjidhjen e Kontratës së Punës”,** për z. **M.P.** masë e cila nuk është zbatuar, ***prandaj rikërkojmë zbatimin e plotë të këtij rekomandimi.***

Nga verifikimi rezulton se nga 11 masa disiplinore “Vërejtje” të rekomanduara nga KLSH, janë zbatuar 10 prej tyre, duke mos u zbatuar se masa disiplinore “Vërejtje”, për z. **J.P. prandaj rikërkojmë zbatimin e plotë të këtij rekomandimi.**

4. BASHKIA KURBIN

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “ Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar ” dhe kontratën individuale të punës , nenit 64, shkronjat **g** dhe **k** të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenet 15 dhe 25 të ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **KLSH i rikërkon Kryetarit të Bashkisë Kurbin** që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore për z. G.D. me detyrë Nënkryetar i Bashkisë Kurbin dhe Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO).

5. BASHKIA PËRMET:

Nga 6 persona të rekomanduar për dhënien e masës disiplinore **“Vërejtje”** deri në **“Largim nga Shërbimi Civil”,** është zbatuar vetëm për një rast, për 5 persona të tjerë, nuk është dhënë masë disiplinore, 2 nga të cilët dy persona kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës,prandaj rikërkojmë të meren masa disiplinore ndaj 3 punonjësve si më poshtë:

1. Z. Ë.N. me detyrë specialist shërbimesh,

2. Z. D.M. me detyrë inspektor taksash dhe në cilësinë e anëtarit të KPVV

3. Zj. M.F. me detyrë juriste në zyrën juridike dhe në cilësinë e anëtarit të KPVV.

6.BASHKIA BERAT:

Nga KLSH-ja janë rekomanduar **14 masa disiplinore,** nga të cilat 5 masa për punonjësit pjesë e shërbimit civil të cilat janë pranuar nga Subjekti. Nga masat e pranuar janë zbatuar 2 masa duke mos u zbatuar 3 masa disiplinore. Për punonjësit të cilët marrëdhëniet juridike të punës rregullohen me **“Kodin e Punës”** janë rekomanduar 9 masa disiplinore, të cilat janë pranuar, ndërkohë që nuk është zbatuar 1 masa disiplinore.

Prandaj i rikerkojmë Kryetarit të Bashkisë që t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për **4 punonjësit** e mëposhtëm:

a- "Largim nga Shërbimi civil", për 3 punonjës si më poshtë:

1. Znj. E.P. me detyrë ish-N/kryetare Bashkie aktualisht specialiste në Drejtorinë e Tatim Taksave, në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkelje në 16 procedura të prokurimit publik.

2.L.B. me detyrë Drejtore Finance, në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkelje në 6 procedura të prokurimit publik.

3.M.S. me detyrë Drejtore e Administrimit të Pronave cilësinë e Anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkelje në 17 procedura të prokurimit publik.

b- "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj".

1.V.Z. me detyrë specialist në Drejtorisë së Investimeve, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkelje në 5 procedura të prokurimit publik.

7. BASHKIA SKRAPAR

Nga KLSH-ja janë rekomanduar **8** masa disiplinore, nga të cilat 5 masa për punonjësit pjesë e shërbimit civil të cilat janë pranuar nga Subjekti. Nga masat e pranuar janë zbatuar 3 masa duke mos u zbatuar 2 masa disiplinore. Për punonjësit të cilët marrëdhëniet juridike të punës rregullohen me "*Kodin e Punës*" janë rekomanduar 3 masa disiplinore, të cilat janë pranuar, ndërkohë që nuk janë zbatuar 2 masa disiplinore, për të cilat i rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë që t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 2 punonjësit e mëposhtëm:

- "Largim nga shërbimi civil", neni 58, germa "ç", për dy punonjës.

1. Z. N.G. në funksion Drejtor Ekonomik në cilësinë e anëtarit të KVO;

2. Z. B.H. në funksion Drejtor i Planifikimit e zhvillimit Urban;

8. BASHKIA POLIÇAN:

Nga KLSH-ja janë rekomanduar **8** masa disiplinore, nga e cila me "*Statusit të Nëpunësit Civil*" janë rekomanduar 2 masa disiplinore, nga këto pranuar 2 masa por të pa zbatuara. Sipas "*Kodit të punës*" janë rekomanduar 6 masa disiplinore, nga këto pranuar 3 masa por të pa zbatuara.

I rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë që t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, "*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit*", për 2 punonjësit pjesë e shërbimit civil si më poshtë:

1. Znj. A.C. emëruar në fillim specialiste e taksave me Urdhrin nr. 07, datë 15.01.2014, përfituar statusin e nëpunësit civil më datë 14.10.2014 dhe më vonë më datën 26.10.2015 emëruar Drejtore e Zyrës taksave Bashkia Poliçan e në vazhdim.

2. Z. M.K. në funksion inspektor në zyrën e shërbimeve, emëruar me Urdhrin nr. 70, datë 15.07.2007.

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punësi rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, "*Vërejtje*" për **6 punonjësit** e mëposhtëm:

1. Z. Ç.B. inspektor në zyrën e tatim-taksave.

2. Z. K.K. me detyrë, agjent tatimor Komuna Vërtop, emëruar me urdhrin nr. 22, datë 01.10.2009, me urdhrin nr. 06, datë 04.02.2014, përgjegjës i zyrës taksave dhe me urdhrin e kryetarit të bashkisë, nr. 112, datë 06.08.2015 është emëruar specialist tatimesh dhe administrimin të taksës së tokës bujqësore e në vazhdim.

3. Z. A.S. me detyrë, agjent i administrimit të taksës bujqësore në Njësinë administrative Vërtop, me vendimin nr. 10 datë 25.05.2010 ka qenë emëruar Drejtori i Taksave, ish-komuna Vërtop dhe me urdhrin e kryetarit të bashkisë nr. 112, datë 06.08.2015 është emëruar inspektor i taksave në Njësinë administrative Vërtop.

4. Z. D.D. me detyrë inspektor i taksave dhe administrimit të taksës së tokës Njësia administrative Terpan, emëruar me urdhrin e kryetarit të bashkisë nr. 113, datë 06.08.2015.

5. Znj. L.Xh. me detyrë ish-Drejtores e burimeve njerëzore për periudhën 2013-2014 deri në muajin gusht 2015 njëherazi edhe Nënkryetare e Bashkisë.

6. Znj. A.K. me detyrë arkëtare.

9. BASHKIA MALIQ:

Nga KLSH janë rekomanduar **3** masa disiplinore. Nga rekomandimet “Largim nga shërbimi civil”, janë pranuar 3 masa. Nga rekomandimi i lënë “Vërejtje” dhe “Vërejtje me shkrim”, pa zbatuar 2 rekomandime, ndërkohë që nuk është zbatuar 1 masa disiplinore. Prandaj **i rekomandojmë Kryetarit** të Bashkisë që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për:

1. Z. A.Z. me detyrë Specialist i Pyjeve në Komunën Libonik,

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe kontratës individuale të punës neni 11, **i rekomandojmë** kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, për:

1. Znj. N.Gj. me detyrë ish-Përgjegjëse e Zyrës së Planifikim e Zhvillimit Urban, aktualisht Përgjegjëse e Zyrës së Koordinim Zhvillimit në Bashkinë Maliq.

10. BASHKIA POGRADEC:

Nga KLSH-ja janë rekomanduar **5** masa disiplinore, nga të cilat 2 masa për punonjësit pjesë e shërbimit civil të cilat janë pranuar nga subjekti. Nga masat e pranuar pa zbatuar 2 masa disiplinore, për të cilat i rikerkojmë Kryetarit të Bashkisë që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, për:

1. M.K. me detyrë Specialist për politikën ekonomike, në cilësinë ish-Nëpunës Zbatues.

2. F.B. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Administrimit të Aseteve, Lejeve dhe Autorizimeve.

- Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 11, **i rekomandojmë** kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”, për 3 punonjës si më poshtë::

1.Ç.B. me detyrë Drejtor i Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, për periudhën datë 1.10.2015 e në vazhdim, administrativo-territorial”, Kreu III, pika 1.

2.V.M. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave për periudhën 01.12.2015 e në vazhdim,

3.N.T. me detyrë Koordinator për Njësitë Administrative në Bashkinë Pogradec, ish-Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit për periudhën datë 19.8.2015 deri 29.02.2016.

11. BASHKIA PRERENJAS:

Nga KLSH janë rekomanduar **9** masa disiplinore, nga të cilat 3 masa për punonjësit pjesë e shërbimit civil të cilat janë pranuar nga subjekti. Nga masat e pranuar pa zbatuar **3** masa

disiplinore. Për punonjësit të cilët marrëdhëniet juridike të punës rregullohen me “Kodin e Punës” janë rekomanduar 6 masa disiplinore, të cilat janë pranuar 6 masa të cilat nuk janë zbatuar.

Prandaj i rikerkojmë Kryetarit të Bashkisë që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore “**Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj**”, për:

1. **Z. E.V.** Kryetar i KVO, ish-Komuna Qukës.
2. **Z. S.A.** anëtar i KVO, ish-Komuna Qukës.
3. **Z. E.K.** anëtar i KVO, ish-Komuna Qukës.

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

duke vendosur dhënien e masave disiplinore “**Vërejtje me shkrim**”, për:

1. **Znj. M.K.** me detyrë ish Përgjegjëse e Zyrës së Taksave aktualisht specialiste Transporti në Bashkinë Përrenjas.
2. **Z. A.G.** me detyrë ish Përgjegjëse e Zyrës së Taksave ish Komuna Qukës aktualisht specialiste taksash në Bashkinë Përrenjas.
3. **Znj. G.K.** me detyrë ish-specialist pyjesh në, ish-Komunën Rrajzë (sot Njësia Administrative Rrajzë e Bashkisë Përrenjas)
4. **Z. Xh.N.** me detyrë ish-specialist pyjesh në, ish-Komunën Qukës (sot Njësia Administrative Qukës e Bashkisë Përrenjas)
5. **Znj. K.K.** me detyrë ish-Drejtoresh Financës në ish-Komunën Qukës (për periudhën 01.01.2014-30.06.2015) si dhe Drejtoresh e Financës dhe Tatim-Taksave në Bashkinë Përrenjas në cilësinë e nëpunësit zbatues (për periudhën 21.09.2015-31.12.2015), aktualisht Përgjegjëse e Zyrës së Financës.
6. **Znj. D.Ç.** me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit të Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues (për periudhën 01.01.2014-30.06.2015) aktualisht specialiste finance në Drejtorinë e Financës dhe Tatim-Taksave në Bashkinë Përrenjas.

12. BASHKIA ELBASAN

Nga KLSH me shkresën nr. 129/10, datë 27.5.2016 janë rekomanduar 20 masa disiplinore, bazuar në ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, ku Komisioni i Disiplinës ka filluar procedurën për 2 punonjës, por nuk ka marrë vendim. Për 16 punonjësit e tjerë ju është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, kurse për 2 punonjës nuk ka marrë masa

Për të cilën i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të vazhdojë procedurat e masave disiplinore ndaj:

1. **Z. R.H.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban.
2. **Zj. O.D.** me detyrë Drejtoresh e Drejtorisë Juridike.

13. BASHKIA RROGOZHINË

Nga KLSH me shkresën nr. 1193/11, datë 25.4.2016 ka rekomanduar Bashkisë Rrogozhinë të marrë masën disiplinore “Vërejtje”, për 11 punonjës, të cilat nga verifikimi rezultojnë të pa zbatuara. Prandaj i rikerkojmë Kryetarit të Bashkisë që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për 11 punonjës, si më poshtë:

1. **Z. F.M.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe në cilësinë e Kryetarit të KPVV (për periudhën 01.07.2013-31.08.2015)
2. **Z. L.H.** me detyrë Inspektor Taksash dhe në cilësinë e anëtarit të KPVV (për periudhën shtator 2013-korrik 2015)
3. **Z. A.K.** me detyrë Inspektor-llogaritar, me detyrë inspektor taksash dhe në cilësinë e anëtarit të KPVV
4. **Z. B.P.** me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse dhe në cilësinë e Kryetarit të KPVV (për periudhën 04.08.2015-31.12.2015),

5. **Z. P.H.** në funksionin e Përgjegjës të Futboll Klub “Egnatia” Rrogozhinë.
6. **Z.Sh.D.** me detyrë Jurist në Ish-komunën Gosë dhe aktualisht në Njësinë Administrative Gosë, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT)
7. **Z.G.E.** me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Financës në ish-Komunën Gosë dhe aktualisht specialist finance në Njësinë Administrative Gosë
8. **Z.K.** në cilësinë e Inspektorit të IMTV
9. **A.T.** në cilësinë e Inspektorit IMTV
10. **B.D.** në cilësinë e Inspektorit të IMTV
11. **N.B.** në cilësinë e Kryetares së KVO-së (sh Komuna Lekaj)

14. KËSHILLI I QARKUT TIRANË

Nga ana e KLSH me shkresën nr. 572/8, datë 9.9.2016 “Raporti përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet” janë dërguar rekomandimet për 2 masa disiplinore nga të cilat nuk është zbatuar asnjë masë disiplinore, prandaj rikërkojmë zbatimin e masave për personat si më poshtë:

-“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 pika “c”.

1. **Znj. E.D.** me detyrë ish-Drejtores Ekonomike, aktualisht në pozicionin specialist finance në Drejtorinë e Koordinimit Zhvillim.

-“Vërejtje”, neni 58 germa “a”.

1. **Znj. B G** me detyrë Drejtor e Koordinimit Zhvillim (në cilësinë kryetares së KBVV).

15. PREFEKTURA E QARKUT TIRANË

Nga KLSH me shkresën nr. 512/6, datë 10.10.2016 i janë rekomanduar **8 masa disiplinore**, nga të cilat janë zbatuar 2 rekomandime, kurse 6 rekomandime nuk janë zbatuar, për të cilët rikërkojmë si më poshtë:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të nenit 11, nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, **i rikërkojmë** Prefektit të Qarkut Tiranë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dhënien e masave disiplinore “Vërejtje” deri në **“Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”**, për **6 punonjës** si më poshtë:

1. **z. E.K.** me detyrë Drejtor i KVVTP-së nga 03.06.2014 deri më 13.09.2015

2. **znj. L.T.** me detyrë Drejtor i KVVTP-së nga 13.09.2015 e në vazhdim

3. **z. M.M.** me detyrë specialist i KVVTP-së

4. **znj. A.J.** me detyrë specialist i KVVTP-së

5. **z. Gj.M.** me detyrë specialist i KVVTP-së

6. **z. A.P.** me detyrë specialist i KVVTP-së.

16. PREFEKTURA E QARKUT VLORË

Me shkresën nr. 348/10, datë 30.06.2015 KLSH i ka rekomanduar Prefektit Qarkut Vlorë, fillimin e procedurave për marrjen e masë disiplinore ndaj **z. D.H.** me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Prefekturës së Qarkut Vlorë. Nga verifikimi rezulton se deri me datën 09.12.2016, kjo masë nuk është zbatuar.

Mbështetur në nenin 58 shkronja “b” e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, datë 30.05.2013 i ndryshuar, në pikat 9, 10,11 dhe 12 të VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” **i rikërkojmë Prefektit të Qarkut Vlorë** që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, **të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, ndaj z. D.H.** me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Prefekturës së Qarkut Vlorë,

Për shkeljet e mëposhtme:

Në shprehjen e ligjshmërisë mbi vendimet e Këshillit Bashkiak Vlorë nr. 45, datë 09.10.2014 “Për miratimin e dhënies së konçesionit për administrimin e shërbimi të parkimit me pagesë në rrugë” dhe nr. 57, datë 11.12.2014 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së konçesionit për administrimin e shërbimi të parkimit me pagesë në rrugë”, ka miratuar dhe shprehur se vendimet “**Vlerësohen të ligjshëm**”, duke lejuar dhënien me konçesion të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë, edhe pse me dijeni të plotë në këtë marrëdhënie të krijuar Bashkia Vlorë nuk ka qenë në cilësinë e pronarit, por të administratorit të pasurisë, pasi nga Këshilli i Ministrave nuk është miratuar lista përfundimtare e pasurive të paluajtshme të cilat u kalojnë në pronësi apo përdorim bashkisë.

Për vendimin nr. 57, datë 11.12.2014, akti nuk ka dalë nga Prefekti i Qarkut Vlorë, por nga Sekretari i Përgjithshëm i Prefekturës, me shënimin “**Në mungesë dhe me porosi**”, veprim ky haptazi në tejkallim të kompetencave të tija ligjore, kjo pasi autorizimi i përdorur nuk përkon me rastin konkret, ku Urdhri i Prefektit nr. 68, datë 30.07.2014 “Për delegim kompetencash” ka pasur efekt vetëm për arsye të lejes vjetore të Prefektit, ndërsa nënshkrimi i vendimit të KB nr. 57, datë 11.12.2014, daton afro 5 muaj më pas. Miratimi dhe konfirmimi mbi ligjshmërinë e akteve, vet ligji organik nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për Prefektin”, ja atribuon këtë të drejtë, njëherazi detyrim vetëm Prefektit, si atribut i pa delegueshëm prej tij. Për vendimin e KB nr. 57, datë 11.12.2014, ka dhënë miratim duke u shprehur se vendimi vlerësohet i ligjshëm edhe pse studimi i fisibilitetit është kryer për një afat 10 vjeçar, ndërsa miratimi në Këshillin Bashkiak është bërë për një periudhë 15 vjeçare. Për sa më sipër me veprimet dhe mosveprimet e mësipërme Prefekti i Qarkut Vlorë dhe Sekretari i Përgjithshëm kanë vepruar në kundërshtim me neni 14, të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për Prefektin”, i ndryshuar dhe pjesën VI-Veprimtaria Administrative, neni 105 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

17.BASHKIA TIRANË:

a. Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna për projektin infrastrukturor “Ndërtimi, Rikonstruksioni dhe Rinovimi i Unazës së Vogël”.

Me shkresën nr. 999/9, datë 22.02.2016 KLSH ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Tiranë: të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet e trajtuara për secilin punonjës në Raportin Përfundimtar të Auditimit Tematik dhe të filloi procedurat për dhënien e masave disiplinore, ndaj 3 punonjësve. Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim nuk është marrë në shqyrtim, prandaj i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tiranë, që ti kërkojë Komisionit disiplinor fillimin e procedurave disiplinore për 7 punonjësit e mëposhtëm:

- 1.z. G.j.B.** me detyrë Drejtor i Planifikimit të Territorit
- 2.z. T.T.** me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Punëve Publike dhe Kryetari i Këshillit Teknik,
- 3.z. M.K.** me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të Projektimit
- 4.z. S.D.** me detyrë Kryeinspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit
- 5.zj. I.N.** me detyrë Drejtore e Përgjithshme, Juridike dhe Aseteve
- 6.z. E.N.** me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të Shpronësimeve
- 7.zj. Sh.C.** me detyrë Specialiste pranë Sektorit të Shpronësimeve

b. Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna për Bashkinë Tiranë, pas auditimit në Prefekturën Tiranë Drejtoria a Shërbimit dhe Mbrojtjes nga Zjarri e Shpëtimi.

Me shkresën nr. 999/9, datë 22.02.2016, KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Tiranë, marrjen masave disiplinore për 6 punonjës, ku nga verifikimi rezultoi se nuk ishte marrë në analizë ky material, prandaj i rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë Tiranë që ti kërkojë Komisionit disiplinore marrjen e masave disiplinore **për 6 punonjësit e mëposhtëm;**

a. “Vërejtje më paralajmërim” pika (ii), për shkelje të lehta disiplinore, për 4 punonjësit e mëposhtëm;

1.A.R. me detyrë personel zjarrfikës luftues, me gradë Agjent filluar punë më datën 14.02.2014, vazhdon.

2.A.C. me detyrë Komandant Stacioni Kamzë me Gradë Inspektor, filluar punë më datën 01.11.2014 vazhdon.

3.E.C. me detyrë Inspektor parandalimi, me Gradë Agjent në Stacionin PMNZSH Kombinat, filluar punë më datën 31.12.2014, vazhdon.

4.L.Sh. me detyrë Komandant Stacioni, PMNZSH Kombinat, filluar punë më datën 31.12.2013, vazhdon.

II. “Ulje me një gradë, për një periudhë deri në 6 muaj”, pika (ii), për shkelje të rënda disiplinore, për një **1 punonjës**:

1.z. S.T. me detyrë Inspektor Parandalimi në Stacionin PNMZSH, Kinostudio, me Gradën Agjent, filluar punë më datën 26.05.2014, vazhdon punë

b“Përjashtimi nga shërbimi i MZSH-së” pika (iii), për shkelje të rënda disiplinore, për **1 punonjës**:

1-Sh.G. me detyrë ish-shef i sektorit PMNZSH-së të Prefekturës Qarkut Tiranë, që nga data 01.01.2016 me detyrë drejtor i shërbimit mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, (MZSH), kaluar në vartësi të Bashkisë Tiranë .

18- BASHKINË LUSHNJË

Nga 6 masa disiplinore “Zgjidhje e kontratës së punës” të rekomanduara nuk është zbatuar asnjë prandaj, sipas nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neneve 11 dhe 12, **i rikërkojmë** Kryetarit të Bashkisë që t’i rikërkojë Komisionit Disiplinor, marrjen e masës disiplinore “**Zgjidhje e Kontratës së Punës**”, për:

1. zj. T.K. me detyrë Nënkyetare e Bashkisë, në cilësinë e Kryetare e KVO.

2. zj. M.H. me detyrë Drejtore e Planifikimit të Territorit, në cilësinë e anëtare e KVO.

3. zj. J.B. me detyrë ekonomiste, në cilësinë e anëtar i KVO.

4. zj. K.H. me detyrë juriste, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit,

5. zj. M.L. ing. Ndërtimi, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit,

6. zj. B.K. me detyrë juriste, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit.

b.Për subjektet e audituara në tremujorin e IV-të të vitit 2015

Nga 101 masa disiplinore të rekomanduara, janë pranuar 99 masa prej tyre janë zbatuar 40 masa disiplinore ose në masën 40 %, duke mos u zbatuar 48 masa, nga të cilat 23 masa u përkasin 3- ish Komunave dhe 9 masa Bashkisë Korçë ku kjo e fundit i ka pranuar, duke i konsideruar edhe 44 masa të realizuara, realizimi shkon në 63 masa (40+23) ose në masën 62 %

Nuk kanë zbatuar masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH respektivisht, Bashkitë: Gjirokastër 18 masa, Bashkia Korçë 9 masa disiplinore (sqarojmë se nga kryetari i Bashkisë Korçë për këto masa i janë dërguar për vendimmarrje Komisionit Disiplinor, por ky i fundit pas shqyrtimit të shkeljeve disiplinore ka vendosur ”Ndërprerjen e ecurisë Disiplinore”.

Dhe 3 ish- komuna të cilat janë suprimuar dhe masat konsiderohen të realizuara respektivisht: ish Komuna Petrelë 18 masa disiplinore (aktualisht Njësi Administrative në përbërje të Bashkisë Tiranë) ish-Komuna Balldre Lezhë, 2 masa disiplinore (aktualisht Njësi administrative në përbërje të Bashkisë Lezhë), ish-Komuna Gostimë Cërrik 3 masa disiplinore, (aktualisht Njësi administrative e Bashkisë Cërrik)

19. BASHKIA KORÇË: (audituar tremujorin e IV-të 2015)

Nga verifikimi rezultoi se nga 14 masa të rekomanduara nga KLSH, janë zbatuar 4 masa disiplinore, 2 nga të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë Korçë, para se të fillonin procedurat disiplinore.

Për **9 punonjësit e tjerë**, Komisioni Disiplinor, pas verifikimit të provave dhe fakteve ka marrë vendim për **“Për ndërprerjen e ecurisë disiplinore” me arsyetimin** se Agjencia e Prokurimit Publik është institucioni i vetëm sipas ligjit që i propozon direkt marrjen e masave autoritetit kontraktor, kjo për qëllim unifikimi”. Konstatohet se Bashkisë Korçë, nuk i është propozuar asnjë masë nga Agjencia e Prokurimit Publik për 9 punonjësit e mëposhtëm:

1. **Znj. B.Th.** Zëvendëskryetare e Bashkisë Korçë.
2. **Znj. D.T.** Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit:
3. **Znj. M.S.** Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve:
4. **Z. B.M.** Specialistë në Drejtorinë e PKZHT:
5. **Z. O.L.** Specialist në Drejtorinë e PKZHT:
6. **Znj. M.L.** Përgjegjëse e Sektorit të Kontabiliteti:
7. **Z. O.P.** specialist në Drejtorinë e Financës:
8. **Z. H.N.** specialist në Drejtorinë e PKZHT:
9. **Znj.A.D.** Drejtore e Drejtorisë Juridike.

I kërkojmë, Titullarit të institucionit që ti tërheqë vëmendjen Komisionit Disiplinor të Bashkisë për mos vlerësimin me objektivitet të fakteve dhe rrethanave sipas rekomandimeve të KLSH.

20.BASHKIA GJIROKASTËR: (audituar tremujorin e IV-të 2015)

Nga KLSH-ja janë rekomanduar 18 **masa disiplinore**, të gjithë punonjës me *“Statusin e Nëpunësit Civil”*, janë dhënë masë disiplinore për 2 persona, nuk është ngritur Komisioni i Disiplinës dhe nuk ka marë masë disiplinore për 16 punonjës të tjerë.

Mbështetur në nenin 58 “Ilojet e masave disiplinore” shkronja (b), të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 germat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen vendore”, i **rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë**, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 16 punonjësit e mëposhtëm:

“Vërejtje” deri në “Largim nga puna”, neni 58, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 sipas përgjegjësave përkatëse, për këta persona:

1 **z. I.Ç.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës dhe Zhvillimit, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Masën disiplinore “Vërejtje”, për këta persona:

2. **z.E.L.** me detyrë Inspektor i Kadastrës Urbane dhe Regjistri Elektronik Kombëtar, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

3. **zj. A.C.** me detyrë Inspektor Kontraktor dhe Arkivat, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

4. **z. S.G.** me detyrë Inspektor Jurist, në cilësinë e Juristit në Njësinë e Prokurimit,

5. **z.E.R.** me detyrë Inspektor në Sektorin e Urbanistikës dhe Zhvillimit, në cilësinë e Specialistit të Njësisë së Prokurimeve,

6. **z. H.Ç.** me detyrë Drejtor në Drejtorinë Juridike e Prokurimeve QKR dhe QKL, në cilësinë e Specialistit të Njësisë së Prokurimeve,

7. **zj. M.K.** me detyrë Inspektore Prokurimeve, në cilësinë e Specialistit të Njësisë së Prokurimeve,

8. z. V.B. me detyrë Inspektor Urbanist Ligjor dhe Trashëgimisë, në cilësinë e Specialistit të Njësisë së Prokurimeve.

9. z. A.P. me detyrë Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave Tatim-Taksave, Tarifave dhe Tregu me Shumicë.

10. z. A.P. me detyrë Inspektor për Planifikimin dhe Realizimin e të Ardhurave Vjetore.

11. z. B.L. me detyrë Inspektor i Përpunimit dhe Bashkërendimit në Terren,

12. z. L.S. me detyrë Inspektor të Terrenit,

13. z. M.B. me detyrë Inspektor të Terrenit,

14. z. V.M. me detyrë Inspektor të Terrenit,

15. z. M.B. me detyrë Inspektor të Terrenit,

16. z. M.B. me detyrë Inspektor të Terrenit.

D. PER MASAT ADMINISTRATIVE

Nga **307 masa** administrative të rekomanduara (kryesisht gjoba) IMTV, APP dhe Komisionit të Dhënies së Licencave Profesionale pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, për heqjen e licence profesionale me afat deri 2 vjet, për 4 mbikëqyrësit e punimeve), rezulton se janë **zbatuar 174 masa**, duke mos u **zbatuar 133 masa**, ose në masën 56 %, por duke qenë se 58 masa janë ende në proces shqyrtimi nga APP, (Bashkia Bulqizë 40 masa dhe Bashkia Shijak 19 masa), përqindja e realizimit shkon **në masën 75 %**.

Të detajuara masat administrative paraqiten si më poshtë:

d.1-Për gjobat e rekomanduara Kryeinspektorëve të Inspektoratit Mbrojtjes Territorit (IMTV). pranë Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore (Bashkive).

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimeve përcaktuar në nenet 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, gjatë auditimeve për periudhën e 9/mujorit 2016, KLSH u ka rekomanduar 17 subjekteve, **76 masa administrative**, nga të cilat janë zbatuar **nga 7 subjekte 26 masa** administrative, pa u zbatuar apo janë në proces zbatimi 50 masa si, Bashkia Pogradec 14 masa, Elbasan 12 masa, Has 4 masa, Konispol 4 masa, etj.

Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, **u rikerkojmë** Kryetareve të Bashkive dhe Kryeinspektorëve të Inspektoratit Mbrojtjes Territorit pranë Njësisë të Qeverisjes Vendore, (IMTV), të zbatojnë procedurat ligjore për nxjerrjen e vendimeve dhe ekzekutimin e **vendimeve të gjobave në 18 subjekte për 65 raste**, duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 2% në ditë deri 30 ditë, ose 60% mbi vlerën e gjobës për subjektet për personat si më poshtë:

1. BASHKIA FUSHË-ARRËZ

KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Fushë Arrëz, duke qenë se nuk ka krijuar strukturën e IMTV, që t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë, për mbikëqyrësin **L.B.** dhe kolaudatorit e punimeve **T.S.**

Nga verifikimi rezultoi se Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka bërë kërkesë pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) për të vlerësuar shkeljet e konstatuara dhe vendosjen e masës administrative me gjobë, për mbikëqyrësin L B dhe kolaudatorit e punimeve T S.

Prandaj i **rikërkojmë** Bashkisë Fushë Arrëz, të dërgojë pranë Kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) kërkesën për vlerësimin e shkeljeve të konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë, për :

1. z. L.B. në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në 2 objekte,
2. z. T.S. në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara, në 1 objekt.

2. BASHKIA HAS

Duke qenë se Bashkia Has nuk ka krijuar strukturën e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit, KLSH i ka kërkuar Bashkisë Has që ti kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dënimin me gjobë për 1 mbikëqyrës dhe 3 kolaudator. Nga verifikimi rezultoi se deri më datën 09.12.2016 kjo masë nuk ishte zbatuar, prandaj i **rikërkojmë edhe njëherë Bashkisë Has**, që ti kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dënimin me gjobë për 1 mbikëqyrës dhe 3 kolaudator, **të punimeve si më poshtë:**

1. **Ing. Ll.T.** mbikëqyrës e punimeve, për shkeljet e konstatuara në 3 objektet.
2. **ing. L.P.** kolaudator e punimeve, për shkeljet e konstatuara në 1 objekt.
3. **ing. K.S.** kolaudatori i punimeve, për shkeljet e konstatuara në 1 objekt.
4. **ing. H.K.** kolaudatori i punimeve, për shkeljet e konstatuara në 1 objekt.

3. BASHKIA MALËSI E MADHE

Nga KLSH i është rekomanduar Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, Bashkia Malësi e Madhe, të vlerësojë dhe të marrë masë administrative me gjobë, ndaj 3 mbikëqyrësve dhe kolaudatorëve të punimeve. Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim nuk është zbatuar, prandaj i rikërkojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, Bashkia Malësi e Madhe, të zbatojë procedura e nevojshme ligjore për vendosjen e gjobës, **ndaj 3 mbikëqyrësve të punimeve si më poshtë:**

1. **N.M.** mbikëqyrës e punimeve;
2. **R.Gj.** mbikëqyrës i punimeve;
3. **G.L.** mbikëqyrës i punimeve.

4. BASHKIA BULOQIZË.

Nga KLSH i është rekomanduar Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Bulqizë, të vlerësojë dhe të marrë masë administrative me gjobë **për ing. G.I.** në cilësinë e mbikëqyrësit dhe **ing. T.S.** në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

Nga verifikimi rezultoi se nga ana e Inspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit Bulqizë nuk kanë filluar procedurat për vendosjen e gjobës për **ing. G.I. dhe ing. T.S.** në cilësinë e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Prandaj i rikërkojmë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Bulqizë fillimin e procedurave për vendosjen dhe arkëtimin e gjobës ndaj 2 personave si më poshtë:

1. **Ing. G.I. në masën 100,000 lekë për** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “*Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare Gjoricë dhe Ndërtim Palestër*”, ish-Komuna Gjoricë.

2. Ing. T.S. në masën 500,000 lekë, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare Gjoricë dhe Ndërtim Palestër”, ish-Komuna Gjoricë, Bulqizë.

5.BASHKIA MIRDITË

Nga Bashkia Mirditë, nuk i është kërkuar Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vendosë masë administrative me gjobë, për 2 kolaudatorët, **prandaj rikërkojmë vendosjen e gjobës për:**

1.Ing. V.D. në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: “Rikonstruksion Shkolla 9-vjeçare Kaçinar” ish-komuna Kaçinar, Mirditë.

2.Ing. M.P. në cilësinë e kolaudatorit punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin “Ndërtim Ujësjellësi për Fshatrat Arrëz, Kaçinar, Simon”, ish-Komuna Kaçinar, Mirditë.

3.Nga Bashkia Mirditë, nuk i është kërkuar Komisionit të Licencave pranë Ministrisë Zhvillim Urban, heqja e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim (heqjen e Licencës profesionale), për një afat **2 vjeçar, z. K.S.** për të cilën rikërkojmë zbatimin e plotë të këtij rekomandimi si më poshtë:

1.z. K.S. (në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës mbikëqyrës [REDAKTUAR], **për shkeljet e konstatuara** duke raportuar dhe likuiduar punime të pakryera në 2 objekte në shumën **12,308,391 lekë. Prandaj rikërkojmë zbatimin e plotë të këtij rekomandimi.**

7.BASHKIA LEZHË

Nga KLSH i është rekomanduar Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **Bashkia Lezhë**, të vlerësojë dhe të marrë masë administrative me gjobë në masën 200,000 leke, ndaj 4 mbikëqyrësve dhe kolaudatorëve të punimeve.

Nga verifikim rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar, **prandaj i rikërkojmë** Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, Bashkia Lezhë, të zbatojë procedura e nevojshme ligjore për vendosjen dhe arkëtimin e vlerës 300,000 lekë, **ndaj 4 mbikëqyrësve të punimeve**, si më poshtë:

1. V.G. në shumën 100,000 lekë, në cilësinë e përfaqësueses ligjore të firmës mbikëqyrëse të punimeve OE [REDAKTUAR], për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Rikualifikimi i Lulishtes së Qendrës së Qytetit Lezhë”

2. Zh.K. në shumën 50,000 lekë, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me “Rikualifikimi i Lulishtes së

3. A.P. në shumën 100,000 lekë, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Ndriçimi dhe Sistemimi i Rrugës Hyrëse të Lezhës, Segmenti Ura Drinit - Rotondo” Bashkia Lezhë,

4. I.D. në shumën 50,000 lekë, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës kolaudatore të punimeve [REDAKTUAR], për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me “Ndriçimi dhe Sistemimi i Rrugës Hyrëse të Lezhës, Segmenti Ura Drinit - Rotondo” Bashkia Lezhë.

8. BASHKIA LUSHNJË

Nga verifikimi rezultoi se nga Kryeinspektori i IMTV Bashkia Lushnjë është aplikuar masa e dënimit me gjobë për 2 mbikëqyrës dhe 2 kolaudatorë. Shumat janë kontabilizuar, por ende deri më datën 09.12.2016 nuk kanë filluar procedurat e arkëtimit, prandaj i rikërkojmë Kryeinspektorit të IMTV dhe nëpunësit Zbatues Bashkia Lushnjë, **që të vazhdojnë procedurat ligjore për**

arkëtimin e vlerës së gjobës vendosur ndaj 4 mbikëqyrësve dhe kolaudatorëve në vlerën **300,000 lekë, si më poshtë:**

1. Ing. **L.V.** me gjobë në masën 100,000 lekë,
2. Ing. **Rr.M.** me gjobë në masën 50,000 lekë,
3. Ing. **V.T.** me gjobë në masën 100,000 lekë,
